Draft-Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029

QËLLIMI I PARË POLITIK I STRATEGJISË

TË REJAT DHE TË RINJTË MARRIN PJESË AKTIVISHT NË SHOQËRI DHE NDIHEN TË FUQIZUAR PËR T'U SHPREHUR ME ZËRIN E TYRE. POLITIKAT NDËRSEKTORIALE RINORE JANË TË KOORDINUARA, TË BAZUARA NË ANALIZA, ME MEKANIZMA TË MIRË FINANCUAR.

QËLLIMI I DYTË POLITIK I STRATEGJISË

MBËSHTETET DHE NXITET NOVACIONI RINOR DHE RRITJA E AFTËSIVE DHE PROFESIONALIZMIT TË TË REJAVE DHE TË RINJVE PËRMES EDUKIMIT CILËSOR NË TIK DHE FUSHA TË TJERA TË ZHVILLIMIT DIGJITAL DUKE RRITUR DHE PËRMIRËSUAR KËSHTU MUNDËSITË PËR TË HYRË NË TREGUN E PUNËS.

QËLLIMI I TRETË POLITIK I STRATEGJISË

MIRËQENIA AKTIVE, E SHËNDETSHME, FIZIKE, SOCIALE DHE MENDORE E TË RINJVE. SIGURIA, MBROJTJA DHE PËRFSHIRJA E TË RINJVE NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE, VEÇANËRISHT PËR ATA TË RINJ QË JANË NË SITUATË RREZIKU APO MËNJANIMI SOCIAL.

Tiranë, Korrik 2022

Lista e Shkurtimeve

AKCESK	Agjencia Kombëtare për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AKKSHI	Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin
AKAFPK	Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë
AKR	Agjencia Kombëtare për Rininë
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
AMA	Autoriteti i Mediave Audio-vizuale
AMMV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla e Administratës Publike
AT	Asistencë Teknike
BE	Bashkimi Evropian
GPN	Grup Pune Ndërministror
IPSIS	Sistemit Informatik i Planifikimit të Integruar
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KiE	Këshilli i Evropës
KM	Këshilli i Ministrave
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MiSHMS	Ministri i Shtetit për Mbështetjen e Sipërmarrjes
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHRF	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
RASH	Rrjeti Akademik Shqiptar
RYCO	Regional Youth Cooperation Office (Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor)
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (State Agency for Strategic Programming and Aid Coordination)
SKR	Strategjia Kombëtare e Rinisë
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TIK	Teknologjia e informacionit

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Përmbledhje dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Qeveria e Shqipërisë e shikon situatën me të rinjtë si një mundësi për zhvillim dhe vënies e rinisë në qendër të zhvillimit. Pikërisht për këtë gjë u krijua një portofol ministri shteti përgjegjës për rininë dhe fëmijët. Kjo është vërtet një mundësi nëse bashkëpunimi ndërqeveritar, me pushtetin vendor, donatorët dhe palët e tjera vjen e rritet. Investimet e bëra tani do ta shtyjnë rininë e Shqipërisë përpara për të trajtuar me efektshmëri sfidat e zhvillimit. Investimet do të rrisin arsimin efektiv të nivelit dytësor, do të reduktojnë dhunën në shkollë, do të krijojnë mundësi për punësimin dhe do të reduktojnë abuzimin, shfrytëzimin dhe martesën e fëmijëve. Ato do të bëjnë të mundur që të realizohet potenciali i plotë i të rinjve. Kjo strategji dëshiron ta bëjë zhvillimin e të rinjve dhe të rejave një çështje për ata vetë dhe të krijojë mundësitë që me rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën e vendit ata të ndryshojnë pozitivisht jetën e tyre duke investuar në mënyrë më të efektshme në të ardhmen e tyre.

Strategjia bazohet në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian 2022-24 ku theksohet (fq 408) se: *"Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 do të jetë dokumenti ku do të bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të synojë hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zejet, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizëm etj. Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 do të jetë në përputhje me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019 – 2027."*

Kjo strategji bazohet në ligjin nr. 75/2019 "Për Rininë" i cili siguron bazën ligjore për hartimin e politikave dhe programeve strategjike për rininë. Me urdhërin e datës 30.12.2021 të Kryeministrit të Shqipërisë, ShTZ, Edi Rama u ngrit edhe grupi ndërministror i punës (GNP) për të hartuar këtë strategji.

Puna për këtë strategji filloi me një seri sesionesh konsultimesh me të reja dhe të rinj në të gjitë vendin në të cilat qeveria përfaqësohej nga Kryeministri dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Në këto sesione konsultimesh morën mbi 1200 të rinj. Takime konsultative u zhvilluan edhe me 45 organizata të ndryshme rinore si edhe me 61 përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore. Me ngritjen e GNP takimet konsultative të rregullta vijuan edhe me këtë grup.

Draftet e para të strategjisë u konsultuan edhe me një grup prej 200 të rinjsh të mbajtur në Qytezën e Fëmijëve në Korcë në datat 19-20 mars 2022.

Politika kombëtare e strategjisë së rinisë dhe përpjekjet programuese përqendrohen në sigurimin e barazisë së mundësive dhe të drejtave, mbështetjes dhe angazhimit për të rejat dhe të rinjtë që janë më të prekshëm, të margjinalizuar dhe më të goditur nga mungesat e shumta, të tilla si varfëria, dhuna, keqtrajtimi, paaftësia dhe përjashtimi social. Kjo strategji synon të orientojë rininë shqiptare për veprim të mëtejshëm i cili ndikon pozitivisht në të ardhmen e tyre. Politikat që zhvillohen në kuadër të kësaj strategjie janë këto qëllime:

- Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërat e tyre
- Rritje e aftësive për punësim e të rinjve, mbështetur nga shërbimet e këshillimit të karrierës dhe punësimit që janë të orientuara nga të rinjtë, rritja dhe përmirësimi i mundësive për të hyrë në tregun e punës në bazë drejtësisë[1] dhe të shanseve të barabarta.
- Mirëqenie aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve
- Novacion dhe edukim cilësor për të mbështetur të rinjtë për të arritur potencialin e tyre të plotë
- Siguri, mbrojtje dhe gjithëpërfshirje e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo vulnerabiliteti.
- Politika ndërsektoriale rinore e koordinuar, e bazuar në fakte, me mekanizma të mirëfinancuar të ofrimit, monitorimit dhe vlerësimit horizontal dhe vertikal

1.1. Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Programin e Qeverisë 2021-2025

Programi qeverisës 2021 – 25 e ka në qendër të vëmendjes rininë sepse e shikon zhvillin e saj dhe rolin që ajo luan në zhvillimin e vendit të integruar në fushat kryesore të programit.

- Në aspektin e **zhvillimit ekonomik** programi qeveritar e vendos theksin te besimi që qeveria ka te të rinjtë *si forca që do të përshpejtojë progresin drejt Shqipërisë së gjeneratës tjetër*, ndaj qëndron angazhimi për të siguruar *jo vetëm mundësi më të mira arsimimi në fushat prioritare si shkencat natyrore, teknologji e informacionit dhe inxhinieri, por mundësi reale për të qenë sipërmarrësit e ardhshëm në fushat e inovacionit e teknologjisë, për të konkurruar denjësisht në tregun global.*
- Në procesin e krijimit **të një ekonomie të fortë të bazuar në modernizim, produktivitet dhe konkurrueshmëri** Shqipëria shihet si qendër rajonale për sipërmarrjet e reja në ekonominë digjitale duke siguruar punë dinjitoze për të rinjtë për të realizuar kështu një kthesë cilësore në punësimin rinor.
- Programi qeveritar në lidhje me zhvillimin e **shoqërisë së dijes** synon rindërtimin e sistemit arsimor për ta bërë atë më të aksesueshëm dhe me infrastrukturë moderne duke i nxitur të *rinjtë në shkenca, teknologji, inxhinieri dhe matematikë, fusha që garantojnë jo vetëm një të ardhme të sigurt për ta, por edhe zhvillimin dhe konkurrueshmërinë e vendit.* Në arritjen e konkurrimit në realitetin global pritet që brezat e rinj të aftësohen *në gjuhë të huaja që në klasën e parë, në kodim, si dhe do të ndërkombëtarizojmë universitet tona në bashkëpunim me universitete simotra*. Në vizionin qeveritar për Shqipërinë 2030, të rinjtë nuk shihen vetëm përmes zhvillimit të infrastrukturës së shërbimeve në kujdesin dhe rritjen e tyre. Fokusi vendoset në zhvillimin e politikave të reja për shëndet më të mirë, edukim më cilësor dhe hapësira alternative që nxisin formimin dhe talentet e të rinjve.
- Në lidhje me **arsimin,** siç reflektohet edhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-26, zhvillimi i infrastrukturave të reja shkollore që erdhi edhe si rezultat i shkatërrimit

[1] Termi "drejtësi" i referohet termit "equity" në gjuhën angleze

të infrastrukturës nga tërmetet e vitit 2019 shoqërohet me një plan për zhvillim të sistemit arsimor që i jep të rinjve njohuri dhe dije konkurruese. Kjo pritet të arrihet me investimet në teknologji dhe infrastrukturë laboratorike, rritjen e vlerës së diplomave në tregun e punës si dhe fuqizimin e universiteteve vendase. Zinxhiri i arsimit pret rritje cilësore edhe duke bërë të detyrueshëm mësimin e gjuhës angleze nga klasa e parë fillore, hapjen e kurseve të kodimit dhe profilizimin e klasave sportive.

- Në fushën e **shëndetësisë** bërja funksionale e 10 qendrave model të mjekësisë familjare me shërbime të integruara socio-shëndetësore priten të kenë edhe shërbime specifike për të rinjtë.
- Me një program të ri mbështetës në **strehim** pritet që familjet e reja të trajtohen me 1 milion lekë mbështetje për pagesën fillestare dhe zbutjen e interesit për blerjen e shtëpisë. Kjo masë nuk e ndërpret programin e banesave sociale në bashkitë e mëdha të cilat do të shkojnë në 2000 në vit dhe do të mbështeten me anë të garancisë sovrane.
- Në procesin e zhvillimit të **biznesit të vogël** merr edhe më shumë vëmendje sipërmarrja e krijuar nga të rinjtë. Fondi i mbështetjes për sipërmarrjet e reja start-up pesëfishohet për të arritur në 10 milionë euro.
- Edhe në **zhvillimin e fshatit drejt turizmit rural** programi ka parashikuar paketa nxitëse për të rinjtë dhe gratë që do të përfshihen në këtë sektor.

1.2. Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Strategjinë e Rinisë së OKB-së dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Sot në botë ka 1,8 miliardë njerëz të moshës 10 deri në 24 vjeç duke qenë brezi më i madh i të rejave dhe të rinjve në histori. Rreth 90 përqind e tyre jetojnë në vendet në zhvillim, ku përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë. Numri i popullsisë brenda kësaj moshe pritet të shkojë në rreth 2 miliardë deri në vitin 2030, rreth 1,9 miliardë të rinj parashikohet të bëhen 15 vjeç[2]. Të lidhur me njëri-tjetrin si kurrë më parë, të rinjtë duan dhe tashmë të kontribuojnë në qëndrueshmërinë e komuniteteve të tyre, duke propozuar zgjidhje inovative, duke nxitur përparimin social dhe duke frymëzuar ndryshime politike. Ata janë gjithashtu agjentë të ndryshimit, duke u mobilizuar për të çuar përpara Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm për të përmirësuar jetën e njerëzve dhe shëndetin e planetit.

Strategjia e OKB-së për rininë 2030 mbështetet në *vizionin global të një bote ku të drejtat njerëzore të çdo të reje dhe të riu bëhen realitet; ku sigurohet se çdo e re apo i ri fuqizohet për të arritur potencialin e vet të plotë; dhe që e njeh kapacitetin, qëndrueshmërinë dhe kontributet positive të të rinjve si agjentë të ndryshimit*[3].

Të pajisur me aftësitë dhe mundësitë e nevojshme për të arritur potencialin e tyre, të rinjtë mund të jenë një forcë shtytëse për mbështetjen e zhvillimit dhe kontributin për paqen dhe sigurinë. Organizatat e udhëhequra nga të rinjtë në bazë të zhvillimeve në këtë strategji pritet të inkurajohen dhe të fuqizohen për të marrë pjesë në përkthimin e Axhendës së vitit 2030 në politika vendore, kombëtare dhe rajonale. Me angazhimin politik dhe burimet e duhura, të

[2] Për më shumë informacion shikoni këtë lidhje: https://www.un.org/sustainabledevelopment/youth/

[3] Për më shumë informacion në lidhje me strategjinë e OKB 2030 shikoni: 18-00080_UN-Youth-Strategy_Web.pdf

rinjtë kanë potencialin për të bërë transformimin më të efektshëm të botës në një vend më të mirë për të gjithë.

Nga perspektiva e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) është veçanërisht e rëndësishme të mos lihet asnjë i ri apo fëmijë mbrapa e pa zhvillim. OZHQ-të që lidhen drejtëpërsëdrejti me të rinjtë dhe të rejat dhe zhvillimin e tyre në këtë strategji janë:

- OZHQ 3 – shëndet i mire dhe mirëqenie. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për moshat e reja, veçanërisht në kushtet e të jetuarit me një pandemi si COVID-19, mbetet një objektiv i rëndësishëm global për t'u arritur.
- OZHQ 4 – arsim cilësor lidhet ngushtë me mundësitë më të mira për punësimi dhe ngjitjen e shkallëve të larta në profesion duke lënë pas varfërinë. Edhe në këtë objektiv situata e pandemisë ka ndikuar drejtëpërsëdrejti në uljen e numrit të fëmijëve që ndjekin shkollat duke vënë në rrezik arritjet e deri më tanishme në edukimin në mbarë botën.
- OZHQ 5 – barazia gjinore me zhvillimet që kanë ndodhur në Shqipëri tregon se ajo është një themel i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe paqësor. Kjo strategji përpiqet ta shikojë këtë në çdo element të saj duke u përpjekur të nxisë masa për punësimin e të rejave dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna me bazë familjare. Njëkohësisht strategjia trajton edhe çështjet e mbështetjes së shprehjes së të rinjve në bazë të identiteve të tyre gjinore dhe të drejtave për pakicat LGBTI.
- OZHQ 8 – punë dinjitoze dhe rritje ekonomike – objektiv i cili sfidon çdo qeveri të globit me situatën e krizës pandemike dhe ndikimit që ajo ka në jetën ekonomike të të rinjve. Marrja e masave për të siguruar punësimin e vazhdueshëm të të rinjve brenda vendit duke rritur mobilitetin rinor dhe punësimin jashtë qendrave urbane shikohet si prioritet në bashkëpunimin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët me ministritë e linjës që sigurojnë punësimin.
- OZHQ 10 – zvogëlimi i pabarazive mbetet prioritet themelor për këtë strategji në kuadër të filozofisë së zhvillimit që nuk lë asnjë të re apo të ri pas duke i bërë ata pjesë integrale në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm me anë të përfshirjes së tyre në procese.
- OZHQ 11 – qytete dhe komunitete të qëndrueshme mund të quhen atëherë kur të rejat dhe të rinjtë e ndërtojnë jetën aty dhe nuk shikojnë migrimin si brenda vendit apo jashtë si alternativë për zhvillim individual. Me rritjen e mundësive për punë, argëtim dhe angazhim social në nivel bashkiak dhe me hapësira të dedikuara për të rinjtë synohet të rritet qëndrueshmëria dhe zhvillimi urban dhe rural kudo nëpër vend.
- OZHQ 13 – veprimi për klimën në një situatë globale ku secili vit arrin rekorde më të larta të ngrohjes globale se tjetri dhe ku cilësia e ajrit dhe ujit është në ulje kërkon angazhimin e të rinjve dhe organizatave rinore për të sjellë ndryshim në qasjen globale kundrejt këtij fenomeni. Lufta në Ukrainë dhe situata pandemike e rrisin sfidën dhe vështirësinë për zhvillim në këtë fushë, por angazhimi në marrëveshje të gjelbëra për punësim dhe zhvillim ekonomik shihen në këtë strategji si masa për të ndikuar edhe në këtë proces. Angazhimi i të rinjve në veprime për klimën mbetet përparësi.

- OZHQ 16 – paqe, drejtësi, institucione të forta përbëjnë thelbin e zhvillimit për punën me rininë duke siguruar që institucionet përgjegjëse për to jo vetëm që ofrojnë shërbime cilësore kundrejt të rinjve por njëkohësisht këto shërbime janë miqësore dhe të përshtatura për të rinjtë. Fuqizimi institucional i organizatave dhe vetë të rejave dhe të rinjve, duke rritur edhe rolin e tyre në zhvillimin e një sistemi drejtësie efektiv shihet me përparësi në masat e kësaj strategjie.
- OZHQ 17 – partneritet për qëllimet siguron nivele të plota të bashkëpunimit si me OKB-në dhe rrjetin e organizatave të saj presente në Shqipëri ashtu edhe partneritet në nivelin rajonal duke pasur për bazë bashkëpunimin rinor të bazuar në përvojën e fituar nga bashkëpunimi i ngritur në kuadër të RYCO.

Të rejat dhe të rinjtë në të gjitha takimet konsultative me përfaqësues të qeverisë kanë cilësuar me forcë nevojën për rritjen e mundësive të tyre për më shumë punësim, këshillim për karrierë dhe zhvillimin e tyre profesional brenda vendit në përputhje kjo me OZHQ 8. Ata janë të prirur dhe e shikojnë zhvillimin e tyre të lidhur me novacionin dhe edukimin cilësor dhe ruajtjen e zhvillimin e vendit dhe mjedisit duke i bërë këto kërkesa të lidhura me OZHQ 4 dhe 13. Të rejat dhe të rinjtë nuk ndalen vetëm në kërkesat e tyre për mirëqenie e shëndet të mirë si fizik dhe mendor por kërkojnë që të jenë të përfshirë në shoqëri e të mos përjashtohen nga zhvillimi. Kjo kërkese e tyre lidhet me OZHQ 3, 10, 11 dhe 16. Ndërsa kërkesat e tyre për bashkëpunim e lëvizshmëri rinore mbështetetn në OZHQ 17.

1.3. Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e Shteteve të Tyre Anëtare (MSA)

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit përbën një dokument udhëzues themelor për politikat që ndërmerr Shqipëria në përputhje me zhvillimin e procesit të integrimit evropian. Kapitulli V, që përmban dispozitave e përgjithshme me anë të nenit 77 që përcakton kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta orienton në strategji aspektet e punësimit të të rejave dhe të rinjve dhe krijimin e kushteve që ata të gjejnë të ardhmen profesionale në Shqipëri.

Titulli VII i MSA që lidhet me Lirinë, Drejtësinë dhe Sigurinë ndërthuret me qëllimet e kësaj strategjie në çdo aspekt duke përfshirë:

- Nenin 78 që ka të bëjë me fuqizimin e institucioneve dhe shtetin e së drejtës në kuadër të fuqizimit të organizimit rinor si edhe në mbështetjen e të rinjve për organizim të pavarur, vullnetarizëm, pjesëmarrje aktive në jetën social politike të vendit dhe mbrojten e tyre veçanërisht në situate rreziku apo kontakti me ligjin.

Titulli VIII i MSA që trajton politikat e bashkëpunimit ndërlidh strategjinë me disa prej sfidave më kryesore që kjo strategji përpiqet të përmbushë si në kuadër të zhvillimit të të rinjve por në angazhimin e tyre në proceset e integrimit evropian:

- Në kuadër të nenit 88 - Bashkëpunimi statistikor – është me rëndësi të zhvillohen statistika të zbërthyera për të rinjtë e të rejat në nivele qarku apo bashkie për të krijuar mundësinë për bërjen e politikave të mirëinformuara rinore. Prodhimi i statistikave do

të krijonte edhe mundësinë për zhvillimin e studimeve rinore në institucionet akademike dhe kërkimore.

- Në kuadër të nenit 99 - Bashkëpunimi social – shikohet me rëndësi rritja e bashkëpunimit të organizatave rinore dhe të rinjve për të sjellë qëndrueshmëri sociale në komunitet ku ata jetojnë duke rritur mundësitë për gjithë përfshirje dhe mos-diskriminim.
- Në kuadër të nenit 100 - Arsimi dhe trajnimi – dhe në përputhje edhe me zhvillimet e parashikuara në strategjinë kombëtare për arsimin dhe atë për punësimin dhe trajnimine, roli i të rinjve për të përmirësuar arsimin, përfitimet për punësim prej tij dhe proceseve të aftësimit dhe shërbimeve të karrierës mbetet themelor në këtë strategji. Ajo i shikon këto procese të ndërthurara edhe me zhvillimet evropiane në mbështetje të rinisë siç është garancia rinore.
- Në kuadër të nenit 101 - Bashkëpunimi kulturor – strategjia ka parashikuar masa të atilla që jo vetëm rrisin bashkëpunimin kulturor me Evropën duke marrë si shembull edhe fitimin e titullit të Kryeqytetit Evropian të Rinisë për Tiranën por edhe duke nxitur rritjen e cilësisë së aktiviteteve pas-shkollore duke zhvilluar angazhimin në arte dhe zeje dhe aktivitet sportive amator.
- Në kuadër të nenit 103 - Shoqëria e informacionit – kjo strategji synon digjitalizimin e shërbimeve të informacionit për të rinjtë në të gjithë vendin duke realizuar një mini-revolucion në mënyrën se si të rinjtë i marrin informacionet për punësim, arsimim dhe argëtim e duke krijuar hapësira të sigurta digjitale për ta. Pajisja e të rinjve me njohuri kundër lajmeve të rreme dhe për të luftuar bulizimin kibernetik pritet të realizohen me masa në këtë strategji në bashkëpunim me AKSHI dhe organizma të tjera.
- Në kuadër të nenit 109: Bashkëpunimi në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik – strategjia parashikon hapa për zhvillimin e punësimit të bazuar në zhvillim teknologjik duke krijuar mundësi për të rritur shkallën e njohurive të kodimit dhe teknologjive të informacionit në nivele masive e jo vetëm brenda shkollave. Si rezultat i bashkëpunimit shkencor pritet edhe zhvillimi i konceptit të "studimeve rinore" si fushë e veçantë e kërkimit shkencor.
- Në kuadër të nenit 110 - Zhvillimi rajonal dhe lokal – strategjia ndërton mbi zhvillimet që kanë ndodhur për bashkëpunimin rinor lokal si ai në kuadër të programit RYCO apo edhe me instalimin e nëpunësve të dedikuar për rininë në çdo bashki. Zhvillimi i Këshillave Vendorë Rinorë po vazhdon në mbarë vendin dhe strategjia parashikon masa për të fuqizuar kapacitetet e këtyre këshillave për të rritur cilësinë e të rinjve në proceset politikë-bërëse vendore.
- Në kuadër të nenit 111 - Administrata publike – strategjia ndërton mbi suksesin e programeve të stazheve për të rejat dhe të rinjtë me rezultate të shkëlqyera në studime dhe programin kombëtar të praktikave të punësimit duke synuar një administrate publike që rinohet vazhdimisht.

1.4. Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Strategjinë e Rinisë të BE-së

Strategjia Evropiane e Rinisë bazohet në 11 qëllime për të rinjtë në Evropë të cilat u realizuan përmes një cikli dialogjesh në vitet 2017-18. Bazuar në konceptin e dialogut me të rinjtë të

kësaj strategjie u zhvilluan takimet konsultative mes të rejave dhe të rinjve dhe organizatave të tyre dhe përfaqësuesve të qeverisë. Si në takimet konsultative të BE-së ashtu edhe ato në Shqipëri, pikëpamjet e shprehura u bënë baza për të zhvilluar vizionin dhe bazën konceptualet të strategjisë. Strategjia e Rinisë së BE-së bazohet në këto 11 qëllime të cilat janë jetësuar edhe në strategjinë kombëtare të Shqipërisë:

1. Lidhja e BE-së me rininë
2. Barazia mes të gjitha gjinive
3. Shoqëria gjithë-përfshirëse
4. Dialog konstruktiv dhe shpërndarje informacionesh
5. Shëndeti mendor & mirëqenia
6. Nxitje dhe përparësi për rininë rurale
7. Punësim cilësor për të gjithë
8. Të mësuar cilësor
9. Hapësirë dhe pjesëmarrje për të gjithë
10. Evropa e gjelbër dhe e qëndrueshme
11. Organizatat Rinore dhe Programe Rinore Evropiane

Është rënë dakort që Strategjia Evropiane e Rinisë duhet të kontribuojë në realizimin e këtij vizioni duke mobilizuar instrumente politikash në nivel evropian si dhe veprimet në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor. Në strategjinë evropiane të rinisë fushat kyçe të sektorit rinor shprehen me tri folje: **Angazhohu, Lidhu dhe Fuqizohu.**

1.5. Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Strategjinë e Rinisë së Këshillit të Evropës

Kjo strategji ka si qëllim të inkurajojë të rinjtë anembanë Evropës që aktivisht të mbështesin, mbrojnë, nxisin dhe përfitojnë nga vlerat thelbësore të Këshillit të Evropës të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Objektivat strategjike të këtij dokumenti synojnë të rrisin angazhimin dhe pjësemarrjen e të rejave dhe të rinjve në proceset demokratike, forcimin e të drejtave të njeriut dhe në vendim-marrje[4]. Këto elemente përfshihen në strategjinë kombëtare me masa specifike që rrisin pjesëmarrjen e të rinjve në jetën e komunitetit dhe në jetën politike të vendit. Këshilli i Evropës në dokumentin e tij strategjik për rininë ka synuar këto prioritete tematike:

- Rigjallërimi i demokracisë pluraliste
- Aksesi i të rinjve në të drejta
- Jetesa e përbashkët në shoqëri gjithëpërfshirëse
- Puna rinore

[4] Për më shumë informacione shikoni këtë faqe: Result details (coe.int)

1.6. Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Agjendën e Ballkanit Perëndimor për novacionin, kërkimin shkencor, arsimin, kulturën, rininë dhe sportet.

Strategjia Kombëtare e Rinisë i bën jehonë edhe agjendës së Ballkanit Perëndimor[5] e cila paraqet një strategji dhe kornizë afatgjatë të bashkëpunimit ekonomik duke dhënë njëkohësisht një vision positive dhe largpamës në veçanti për rininë.

1. Mbështetja e transformimit dixhital;
2. Nxitja e zbatimit të Axhendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe pesë shtyllat e saj;
3. Nxitja dhe mbështetja e qarkullimit të trurit në veçanti me diasporën e Ballkanit Perëndimor;
4. Ngritja e standardeve të larta të cilësisë së arsimit profesional evropian dhe trajnimit si referencë për zhvillimin e aftësive, duke përfshirë mikro kredencialet; të ushqejë shoqëritë e bazuara në njohuri.

1.7. Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI II)

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 (SKZhI II) është dokumenti themelor strategjik që kombinon agjendën e integrimit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Strategjia përcakton vizionin për Shqipërinë si "...demokraci në forcim, në rrugën e saj drejt integrimit në Bashkimin Evropian, me një ekonomi konkurruese, të stabilizuar dhe të qëndrueshme dhe me garanci për të drejtat themelore dhe liritë e njeriut".

- Kjo strategji ka një pikë të veçantë, 11.9 e cila lidhet me me fuqizimin e rinisë përballë këtyre sfidave:
  - Nevojën për më shumë pushtet ekonomik rinor përmes programeve të nxitjes së punësimit, arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale;
  - Nevojën për krijimin e hapësirave publike për t'iu shërbyer të rinjve;
  - Fuqizimin e kapaciteteve të organizatave rinore;
  - Kriijmin e rrjeteve rinore, këshillave të qarqeve dhe komisioneve kombëtare të konsultimit për çështjet rinore; dhe
  - Nevojën për rritjen e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në komunitet dhe programeve ndër-rajonale.
- Kjo strategji paraqet si vizion: "Një rini aktive dhe me barazi në të gjitha fushat e jetës shoqërore, e shëndetshme, e arsimuar dhe me një status të konsoliduar në shoqëri" duke u bazuar te *aktivizmi i saj dhe barazia në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Rinia vizionohet si e shëndetshme, e arsimuar dhe me një status të konsoliduar në shoqëri.*
- Në këtë dokument parashtrohen edhe këto objektiva strategjikë:
  - Mbështetja dhe integrimi i të rinjve në tregun e punës, si punëmarrës dhe sipërmarrës[6];

[5] Për më shumë informacion dhe për të lexuar agjendën klikoni: ec_rtd_western-balkans-agenda-overview.pdf (europa.eu)
[6] Kjo do të arrihet përmes: krijimit të Shërbimit Kombëtar Rinor, si një strukturë buxhetore nën Ministrinë përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe aspekteve rinore;.2 krijimit të qendrave rajonale rinore, si njësi direkte të shërbimeve rinore; 3 ngritjes së "Inkubatorëve të biznesit për

- Nxitja dhe thellimi i pjesëmarrjes së të rinjve në shoqëri, vendimmarrje dhe mirëqenie[7], dhe
- Forcimi i arsimit dhe formimit profesional për të rinjtë në të gjitha nivelet dhe shtimi i mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës[8].

▪ Të lidhura ngushtë me rininë janë edhe pjesë të tjera të kësaj strategjie shtyllat 2, 3 dhe 4 që kanë të bëjnë me rritjen ekonomike përmes konkurrueshmërisë dhe novacionit, investimin në kapital njerëzor dhe kohezionin social, si edhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit.

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029, së bashku me dokumentet strategjikë shoqërues harmonizohet dhe është në përputhje të plotë me qëllimet, objektivat dhe parashikimet e SKZHI-II sipas shtyllave 2 (Rritja ekonomike përmes rrijtes së konkurrueshmërisë dhe novacionit) dhe shtyllës 3 (Investimi në kapital njerëzor dhe kohezion social).

1.8. Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2022-24

1.8.1. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-24 thekson se: *Ideja e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 vjen si një domosdoshmëri jo vetëm me miratimin e Ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", por edhe për faktin se në dhjetor 2020 ka përfunduar "Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015 – 2020"*. Në këtë mënyrë ky plan e vendos si prioritet të tij rininë si edhe miratimin e kësaj strategjie brenda tremujorit të tretë të këtij viti. Më gjerësisht çështjet me rininë si grup i caktuar shoqëror me interesa dhe nevoja të veçanta trajtohen në kapitullin 26 (fq.400), kapitull i cili në tërësinë e vet përfshin çështje të rëndësishme për rininë siç janë arsimi dhe kultura.

Çështjet që kanë të bëjnë me rininë ky plan i shikon edhe në aspektin e bashkëpunimit dhe integrimit rajonal dhe tema si "Investimi te Rinia në të Ardhmen Evropiane" kanë marrë prioritet në proceset e asociim stabilizimit dhe integrimit me Bashkimin Evropian. Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 22.9.2021, "Rinia" tashmë është fushë e përgjegjësisë së Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, për pasojë dhe puna për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë ka kaluar në këtë ministri. Duke marrë parasysh kalimin e kompetencave nga MAS tek Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka pasur disa ndryshime dhe vonesa në procesin e hartimit të strategjisë[9].

---

rininë" për rritjen e pjesëmarrëjes rinore përmes hapësirave administrative që u sigurojnë sipërmarrësve të rinj hapësirat në zyra dhe objekte të tjera administrative; 4 krijimit të Trupave Kombëtare Rinore; dhe 5 mbledhjes dhe sigurimit të informacionit për programet që nxisin punësimin e të rinjve.

[7] Kjo do të arrihet përmes: 1.rritjes së ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të kapaciteteve rinore dhe organizatave për programet komunitare; 2 mbështetjes së ofruar për mirëqënien rinore, duke u përqëndruar tek nxitja e shëndetit mendor dhe seksual, aktiviteti fizik dhe jeta e shëndetshme; 3 nxitjes së pjesëmarrjes së rinisë në organizatat e shoqërisë civile në të gjitha nivelet; dhe 4. krijimit dhe nxitjes së programeve të praktikave rinore.

[8] Kjo do të arrihet përmes: 1.certifikimit dhe njohjes së arsimit jo-formal, si pjesë e të mësuarit gjatë gjithë jetës; 2 fushatave të ndërgjegjësimit për arsimin profesional të drejtuar drejt kërkesave të tregjeve të punës; dhe 3 ngritjes së zyrave të zhvillimit të karierës, në shkollat e mesme apo në universitete, me qëllim orientimin e të rinjve drejt kërkesave të tregut të punës.

[9] Për më shumë hollësi shiko faqet 412-413 të Planit Kombëtar të Integrimit Evropian http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN_Final.pdf

Përveç trajtimit të çështjeve ikonike të rinisë që lidhen me përmirësimin e cilësisë në arsim, mundësitë praktike për të vënë në zbatim dijet e marra, këshillimin për karrierë dhe argëtimin larg veseve dhe praktikave jo të ligjshme, ky plan ka prerje me strategjinë edhe në këto fusha të tjera të veprimit të tij.

- Programi Kombëtar i Praktikave të Punës
- Programin kombëtar "Edukimi për artet dhe zejet në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar".

1.8.2. Në kuadër të zhvillimeve në sektortin e drejtësisë vlen të theksohet lidhja me zbatimin e dokumentit strategjik "Strategjia e Drejtësisë për të Mitur", i shoqëruar me Planin e Veprimit për periudhën afatgjatë 2018–2021, miratuar me VKM Nr. 541, datë 19.09.2018. Risi e reformës së drejtësisë penale për të mitur janë dhe institucionet e reja, si Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR), si dhe Instituti Multidisiplinor i të Miturve.

1.8.3. Në kuadër të zhvillimeve strategjike në lidhje me shëndetin mendor, SKR-ja lidhet me Planin e Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri 2013 – 2022.

1.8.4. Në lidhje me çështjet e kujdesit shëndetësor parësor procesi i ofrimit të shërbimeve socio-shëndetësore pranë qendrave shëndetsore ofron mundësinë për shërbime miqësore shëndetësore kundrejt të rejave dhe të rinjve. Sipas dokumentit strategjik janë planifikuar që brenda vitit 2024 të vihen në funksionim 10 qendra model të mjekësisë familjare, me shërbime të integruara socio – shëndetësore, me fokus kryesor problemet e shëndetit mendor, por edhe shërbimet për fëmijët dhe të rinjtë dhe kujdesin paliativ.

1.8.5. Strategjia Kombëtare e Rinisë do të ketë pikëprerje edhe me dokumentin e ri të Strategjisë Kombëtare Shëndetësore 2022 – 2030.

1.8.6. Në lidhje me **politikat e punësimit rinor** Strategjia Kombëtare e Rinisë lidhet me atë të Punësim dhe Aftësi (NESS) 2019 – 2022 që ka si qëllim kryesor të identifikojë dhe hartojë politikat e duhura për punësimin dhe formimin profesional të fuqisë punëtore, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësi përgjatë gjithë ciklit të jetës. Plani i veprimit përqendrohet në rritjen e mundësive për punë të denjë përmes politikave efikase të tregut të punës, sigurimit të arsimit dhe aftësimit cilësor të të rinjve dhe të rriturve, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, dhe forcimin e sistemit të qeverisjes së tregut të punës dhe kualifikimeve. 40 zyra punësimi janë organizuar dhe operojnë me modelin e ri të shërbimeve të punësimit në kuadër të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim. Strategjia rishikoi indikatorët deri në vitin 2022, sipas një baze të dhënash, në bashkëpunim të ngushtë me INSTAT. Ka edhe një sërë programesh për nxitjen e punësimit të reja janë miratuar programesh për nxitjen e punësimit është miratuar si:

- Punësim i subvencionuar (ku janë përfshirë punëkërkues te papune nga grupet e veçanta si te rinjtë, gratë me fëmijë ne ngarkim, PAK, romet emigrante etj.
- trajnimit nëpërmjet punës praktika profesionale

- pune publike ne komunitet
- vetëpunësim
- programet COVID-19

Strategjia Kombëtare e Rinisë pritet të jetë një document i drejtëpeshuar nga pikëpamja gjinore. Në raste kur pabarazia gjinore është e dukshme me masat që parashikon fuqizon rolin e vajzave dhe grave të reja. Në këtë aspekt, kjo strategji lidhet me pjesën e planit kombëtar që trajton çështjet gjinore sipas Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030, miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.06.2021. Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë Strategji ndërthuren me masat dhe veprimet e parashikuara në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020 – 2025 të Bashkimit Evropian dhe në lidhje me rininë synon:

- Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, personat me aftësi ndryshe, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj.), duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim.
- Përmbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet (zonat rurale, minoritetet etnike, personat me aftësi ndryshe, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj.) për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.
- Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
- Aplikimi i integrimit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri.

1.9. Përzgjedhja e politikës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë

Metodologjia e përcaktimit të masave prioritare

Për përcaktimin e masave prioritare në këtë strategji janë përdorur mekanizma që kanë lidhje me të rinjtë dhe nevojat e tyre prioritare. Në përcaktimin e masave janë marrë parasysh kategoritë e mëposhtme:

Mosha e të rinjve. Nga pikëpamja moshore masat e formuluara janë parë në lidhje me dhe përputhshmërinë me tri grupe moshore të cilat përputhen edhe me ciklet e zhvillimit edukativo profesional si vijon:

- 15 – 18 vjeç: arsimi i mesëm i lartë ose arsim profesional
- 19 - 24 vjeç: arsimi universitar, zhvillim i mëtejshëm profesional ose punësim

- 25 – 29 vjeç: arsim pasuniversitar ose punësim pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve

Vajzat dhe gratë e reja. Nga pikëpamja e drejtësisë dhe barazisë gjinore masat janë formuluar duke marrë në konsideratë kushtet specifike për vajzat dhe gratë e reja për të përballuar më mirë sfidat e zhvillimit profesional dhe hyrjes në jetën familjare. Në të gjitha rastet masat e parashikuara ndërlidhen me politikat nxitëse gjinore dhe i shërbejnë fuqizimit të vajzave dhe grave të reja duke marrë në konsideratë edhe vajzat e bëra nëna apo martuar në moshë të hershme dhe ato që gjenden në situata vulnerabiliteti. Nga pikëpamja gjinore masat e parashikuara synojnë edhe rritjen e pjesëmarrjes së vajzave si në jetën sociale ashtu edhe në atë profesionale.

Vulnerabiliteti. Në përputhje edhe me strategjitë ndërkombëtare për rininë, ata të rinj që janë në situata rreziku apo ndjehen të diskriminuar apo të përjashtuar për shkak të situatës ekonomike, gjinisë, orientimit seksual, përkatësisë etnike, prejardhjes, etj. Në masat e parashikuara në këtë strategji janë marrë parasysh edhe të rinjtë në kontakt me ligjin për shkak të pjesëmarrjes në aktivitete të paligjshme apo situatave të trafikimit.

Numri i të rinjve. Me prioritet është shikuar edhe çështja e numrit të të rinjve që preken nga masat e parashikuara në strategji. Kështu masat që prekin shumicën e të rinjve janë me më shumë përparësi.

Talenti rinor. Përparësi i është kushtuar edhe rinisë së talentuar dhe nxitjes së talenteve në fushat që kanë të bëjnë me sportin, artin dhe kulturën. Masat prioritare përfshijnë rritjen e talentit dhe të aftësive së të rinjve përmes pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme.

Nxitja e pjesëmarrjes rinore. Element tjetër i rëndësishëm në përcaktimin e masave prioritare është pjesëmarrja dhe angazhimi i sa më shumë grupeve dhe organizatave rinore në to. E gjithë strategjia ka për synim rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve të jetën social ekonomike të vendit. Kjo do të arrihej në mënyrë më efektive përmes rritjes së numrit të të rinjve aktivë nëpër organizatat rinore dhe vullnetarizëm.

Nxitja e punësimit rinor. Përparësi kanë marrë edhe masat që nxisin punësimin e të rinjve, zhvillimin e karrierës së tyre dhe zhvillimin e sipërmarrjes mes të rinjve duke qenë se papunësia mes të rinjve dhe të rejave vazhdon të mbetet e lartë ashtu si edhe numri i të rinjve që nuk janë të përfshirë në arsim, aftësimin apo punësim.

Parandalimi i rrjedhjes së trurit (brain drain). Masat janë renditur edhe në bazë të efektit që ato kanë mbi uljen e migrimit të parregullt dhe parandalimin e rrjedhjes së trurit. Masat që mbështesin të rinjtë që kthehen nga migrimi dhe duan të zhvillojnë idetë e tyre për sipërmarrje në Shqipëri kanë marrë më shumë përparësi.

Nxitja e novacionit. E lidhur me dy faktorët e mësipërm është edhe dhënia e përparësisë për masat që nxisin inovacionin si përmes mbështetjes së ideve të reja dhe start-up ashtu edhe zhvillimeve digjitale.

Roli udhëheqës i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Masat të cilat drejtohen apo koordinohen drejtpërsëdrejti nga ministria përgjegjëse për rininë dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë kanë marrë përparësi më të lartë në krahasim me masat e tjera.

Bashkëpunimi me ministri dhe agjenci të linjës. Po ashtu masat janë përparësuar duke parë edhe nivelin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit me ministritë apo agjencitë e tjera sepse në shumicën e masave udhëheqëse të strategjive janë ministritë e tjera të linjës por nevojitet bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për rininë në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e elementeve rinore në masat e parashikuara.

Si rezultat i analizës së lidhjes me këto dokumente të rëndësishme kombëtare, konsultimeve me të reja dhe të rinj dhe në përputhje me zhvillimet e pritshme në fushën e rinisë u vendos që:

- *Strategjia është 7 vjeçare dhe mbulon periudhën 2022-29 për të dhënë mundësi për të shtrirë politikat rinore në të gjitha fushat e veprimit dhe për të bërë ndërhyrje kuptim-plote dhe strategjike me politikat për të rejat dhe të rinjtë.*
- *Investimet madhore në mjedise rinore, argëtuese dhe sportive duke marrë në konsideratë një skenar realist në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 shtrihen në të njëjtën periudhë me prirjen për të vazhduar edhe më tej.*
- *Strategjia ka një natyrë shumë-sektorëshe dhe ndër-sektoriale:*
    - *Për të arritur në stadin që është ajo është ushqyer nga informacione të mbledhura përmes takimeve me të rinj dhe të reja me pjesëmarrjen e Kryeministrit dhe Ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët*
    - *Janë marrë parasysh programi i ri politik i qeverisë si edhe*
    - *Eshtë kryer një proces sinergjizimi me strategjitë që janë në përdorim dhe ato që janë në proces finalizimi e sipër.*
- *Strategjia shpjegon qëllimet dhe objektivat e politikave për rininë*
- *Strategjia lidhet në natyre dhe qëllime me strategjitë evropiane dhe globale për zhvillimin rinor.*
- *Kostot e parashikuara në kuadër të kësaj strategjie arrijnë në shumën 7,717,439,273 lekë, ndërkohë që fondi për vitin 2022 për mbështetjen për rininë është 161,370,000 lekë ose 0.05% e buxhetit të 2022 dhe gjatë gjithë periudhës së vënies në zbatim (me financimin aktual dhe me rritje modeste) të strategjisë do të jetë 1,690,960,000 lekë. Kjo vlerë është 4.6 herë më e vogël se fondet që nevojiten për të realizuar me sukses të tre qëllimet e politikës dhe objektivat e tyre përkatës.*

Në hartimin e kësaj strategjie nuk u morën parasysh opsione të tjera sepse opsioni i një strategjie 8 vjeçare për këtë kategori të rëndësishme të shoqërisë jo vetëm që është në përputhje me kërkesat për strategjitë ndërsektoriale por konsiderohet si më i përshtatshmi, duke marrë në konsideratë nevojën për ndërhyrje afatmesme dhe të qëndrueshme në këtë sector dhe në përputhje me planet buxhetore në mbështetje të nismave të kësaj strategjie.

Në këtë dokument strategjik parashikohet në një formë gjithëpërfshirëse vizioni i strategjisë, qëllimet e politikave, objektivat specifikë për secilin qëllim, rezultatet e pritshme dhe masat e nevojshme për arritjen e secilit objektiv specifik. Dokumenti parashikon treguesit kryesorë të

performancës, me qëllim matjen e arritjeve, metodave të koordinimit, monitorimit dhe raportimit, si edhe parashikon buxhetin e përgjithshëm të reformës.

Duke marrë në konsideratë se natyrën ndër-sektoriale të zhvillimit rinor dhe pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm ministrish dhe institucionesh ky dokument është konceptuar si një strategji ombrellë, e cila do të përmbajë kryesisht objektivat më të rëndësishëm dhe rezultatet e pritshme nga zbatimi i saj. Për të siguruar arritjen e objektivave specifikë, dokumenti strategjik plotësohet me planin e veprimit të hartuar me synimin për të zbërthyer në hollësi masat e detajuara që secili institucion do të ndërmarrë në përmbushje të secilit objektiv specifik të qëllimeve të politikës. Gjithashtu, Strategjia synon të fuqizojë koordinimin e politikave të komunikimit nëpërmjet rritjes së performancës dhe mekanizmave të manaxhimit të riskut.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 290, datë 11.4.2020 "*Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS*)", procesi për Strategjinë Kombëtare të Rinisë nisi me hartimin e Koncept-Dokumentit të kësaj Strategjie, një dokument i konsultuar gjerësisht dhe i miratuar nga SASPAC në Kryeministri. Plani i Veprimit dhe buxhetet e detajuara janë punuar sipas sistemit IPSIS.

2. Korniza ligjore dhe institucionale

2.1. Kushtetuta

Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon mbrojtje të veçantë për të rinjtë: "Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti". Të drejtat e të rinjve garantohen në kuadrin e të drejtave dhe lirive të njeriut që parashikon ky dokument themeltar i shtetit shqiptar.

2.2. Ligji për Rininë

Ligji me numër 75 u miratua në vitin 2019 nga Parlamenti i Shqipërisë. Ligji specifikon në nenin 3.f se të rinjtë janë personat nga 15 deri në 29 vjeç. Ligji përcakton aktivitetet, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve si në Shqipëri dhe diasporë dhe rrit pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Ligji u miratua për të mbrojtur të drejtat e të rinjve dhe për të krijuar kushte për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e tyre. Ky ligj prezanton disa koncepte të rëndësishme si:

- Edukim joformal për të rinjtë që lidhet me veprimtaritë jashtë sistemit të arsimit dhe të bazuar në vullnetarizëm e pjesëmarrje aktive;
- Dialog i strukturuar mes të rinjve, organizatave të tyre, organizatave që punojnë me ta dhe përfaqësuesve qeveritarë nga ana tjetër duke theksuar bashkëpunimin e bazuar në ndërveprim aktiv, sistematik, transparent, të vazhdueshëm dhe afatgjatë.
- Hapësira e sigurta rinore, por vetëm si hapësira fizike të sigurta për të rinjtë, përfshirë të rinjtë me aftësi të kufizuara por pa kaluar në elementet digjitale apo të platformave sociale e qytetare të hapësirave të sigurta për të rinjtë.

Ligji e përkufizon "punën rinore" si "çdo veprimtari e natyrës sociale, kulturore, arsimore, mjedisore nga/me ose për të rinjtë, në grupe ose individualisht, që ka për qëllim të motivojë dhe të mbështesë të rinjtë, duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe social dhe në

zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi.” por ai nuk përcakton kriteret për “punonjësin rinor apo drejtuesin rinor”.
Ligji parashtron krijimin e një baze ligjore për dy struktura konsultative rinore: Këshilli Kombëtar i Rinisë (KKR) dhe Këshilli Vendor i Rinisë (KVR) të cilat duhet fuqizuar dhe krijuar në ato bashki ku nuk ekzistojnë.
Ligji parashikon sigurimin e burimeve të financimit për politikat, programet dhe aktivitetet rinore, duke theksuar kontributin e buxheteve vendore në këtë drejtim, krahas buxhetit të shtetit. Në të njëjtën kohë, ai parashikon burime të tjera të ligjshme financimi, si të ardhurat e krijuara nga aktivitetet e organizatave rinore, donacionet, sponsorizimet, programet evropiane etj. Ligji parashikon ngritjen e këtyre strukturave organizative:

- Institucioni përgjegjës për rininë është Agjencia Kombëtare për Rininë (AKR) e krijuar me VKM 681 të datës 2.09.2020 që zëvendëson Shërbimin Kombëtar Rinor (SHKR).
- Këshilli Kombëtar i Rinisë, një organ këshillimor që funksionon në kuadër të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe është përgjegjës për rininë. Vendimi i KM i datës 2 dhjetor 2020 përcakton kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të NYC dhe organizimin dhe funksionimin e tij.
- Këshilli Vendor i Rinisë është një organ këshillimor, i cili funksionon në varësi të kryetarit të bashkisë në çdo bashki.
- Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore (OKPR), që krijohet si OJF për të përfaqësuar të rinjtë me VKM nr.274 12.05.2021

2.3. Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (PKVR)

Në vitin 2015, qeveria miratoi PKVR 2015-2020. Vizioni i PKVR ishte në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020, Programin e Qeverisë për Rininë, Strategjinë Kombëtare të BE-së për Rininë, etj. PKVR kishte gjashtë objektiva strategjikë: i) Rritja dhe pjesëmarrja e të rinjve në proceset e vendimmarrjes demokratike, ii) Rritja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës, iii) Shëndeti, sporti dhe mjedisi, iv) Edukimi i të rinjve, v) Mbrojtja sociale dhe vi) Kultura dhe vullnetarizmi. Objektivat e përgjithshme ndaheshin në njëzet e nëntë objektiva specifikë dhe të cilët kishin 161 indikatorë të matshëm.

Në përfundim të këtij plani veprimi dhe bazuar në “Raportin final të vlerësimit të planit kombëtar të veprimit për rininë 2015-20” përgatitur nga MAS me mbështetjen e UNFPA rezulton se 40% e indikatorëve ishin realizuar plotësisht dhe 16% pjesërisht[10]. Në lidhje me secilin nga të gjashtë objektivat specifikë vihet re:

- Për objektivin e parë “Rritja dhe pjesëmarrja e të rinjve në proceset e vendimmarrjes demokratike” raporti i vlerësimit thekson se duhet të vazhdojë me tej forcimi i strukturave dhe kapaciteteve të organizatave rinore dhe e përfaqësimit të të rejave dhe të rinjve në proceset vendim-marrëse.

[10] Kjo pjesë e strategjisë është bazuar në kapitullin V “Gjetje dhe Rekomandime” të “Raportit Final i Vlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015 – 2020” botuar në Qershor 2020 me mbështetjen e UNFPA-së dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

- Për objektivin e dytë "Rritja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës" vlerësimi thekson arritjet në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor për praktikat e punësimit dhe rritjen e nivelit të kualifikimeve profesionale të të rinjve në përputhje me zhvillimin e sistemeve të akreditimit. Nga ana tjetër fuqizimi i burimeve të informacionit mbi punësimin duhet zhvilluar dhe përmirësuar më tej.
- Për objektivin e tretë "Shëndeti, sporti dhe mjedisi" vlerësimi vë re se ka përmirësime si në kuadrin ligjor të politikave për mbrojtën e shëndetit dhe të shtrirjes së edukimit shëndetësor në institucionet dhe kurrikulat e arsimit parauniversitar. Zhvillime ka pasur edhe në fushën e ndërgjegjësimit për ruajtjen e mjedisit. Edhe në këtë objektiv, përhapja e informacionit dhe plafinikimi më i mirë dhe i shpërndarë gjatë gjithë vitit i aktiviteteve mbetet problematik.
- Për objektivin e katërt "Edukimi i të rinjve" vlerësimi thekson përmirësimet e kuadrit ligjor që i ka hapur rrugë reformave, por nga ana tjetër mbetet shumë për të bërë për integrimin e fëmijëve nga minoritet. Digjitalizimi i proceseve mësimdhënëse e mësimnxënëse mbetet po ashtu problematik veçanërisht në lidhje me proceset e mësimit gjatë mbylljes pandemike.
- Për objektivin e pestë "Mbrojtja sociale" mbetet për t'u bërë shumë për krijimin e standarteve të kujdesit social për të gjitha llojet e subjekteve në lidhje me shërbimet për varësinë kundrejt drogave dhe të rinjve me HIV/Aids. Aktivetet e ndërmarra në këtë fushë kërkojnë edhe më shumë
- Për objektivin e gjashtë "Kultura dhe vullnetarizmi" duket se ka qenë problem mungesa e një ligji që rregullon marrëdhëniest mes vullnetarëve dhe organizatave ofruese të vullnetarizmit.

Të gjitha të gjeturat e këtij vlerësimi si edhe problemet që janë hasur në zbatimin e këtij plani janë marrë parasysh në hartimin e kësaj strategjie. Objektivat specifikë të përmendur dhe analizuar më poshtë së bashku me masat dhe aktivitetet e parashikuara marrin në konsideratë problematikën e zhvilluar gjatë zbatimit të këtij plani dhe strategjia synon zgjidhje afatgjata si për problemet ashtu edhe në lidhje me zhvillimin rinor në përgjithësi.

2.4. Lidhja e SKR me strategjitë sektoriale dhe ndër-sektoriale

Ideja e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022-2029 vjen si një zhvillim jo vetëm nga miratimi[11] e Ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", por edhe për faktin se në dhjetor 2020 ka përfunduar "Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020". Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029 do të jetë dokumenti ku do të bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të synojë hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zejet, shtim të aktiviteteve sportive,

[11] Neni 5 i këtij ligji përcakton në pikat a dhe g përcakton përgjegjësinë e ministrisë përgjegjëse për rininë për të hartuar dhe propozuar bazën ligjore dhe politika e veprimtari për rininë si edhe zhvillimin e konsultimeve me të rinjtë lidhur me politikat.

vullnetarizëm etj. Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029 do të jetë në përputhje me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019-2027.

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 22.9.2021, "Rinia" është fushë e përgjegjësisë së Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, për pasojë dhe puna për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë ka kaluar në këtë ministri. Duke marrë parasysh kalimin e kompetencave nga MAS tek Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka pasur disa ndryshime dhe vonesa në procesin e hartimit të strategjisë.

Në kuadër të hartimit të Strategjisë, u theksua se Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka zhvilluar takime me nxënës përfaqësues të shkollave të arsimit të mesëm të lartë, të arsimit profesional, studentë nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, organizata për të rinj dhe përfaqësues nga institucione qendrore dhe vendore[12]. Këto konsultime janë zhvilluar në të gjithë vendin gjatë periudhës tetor-dhjetor 2021, për të përfshirë të rinjtë në hartimin e kësaj strategjie. Në takimet e organizuara janë prekur tema shumë të rëndësishme dhe të ndjeshme për rininë që kishin të bënin me:

- Fuqizimin e jetës rinore në aktivitete dhe organizime të ndryshme
- Rritjen e cilësisë në arsim dhe zhvillimin novativ të tij duke e vënë theksin te zhvillimi aftësive praktike e laboratorike, sipërmarrja, lidhja e arsimit universitar dhe atij profesional me tregun e punës, aftësive për jetën dhe të menduarin kritik
- Fuqizimin e mekanizmave këshillues për punësim dhe karrierë dhe zhvillim profesional
- Mirëqenie fizike dhe mendore bazuar në rritjen e mundësive për t'u marrë me sporte dhe aktivitete të tjera si edhe mundësitë për këshillim psikologjik profesional për të përballuar streset e shkaktuara nga situata pandemike
- Migrimi dhe roli i tij për rininë dhe zhvillimin e vendit
- Punësim të denjë dhe domethënës në përputhje me interesat e të rinjve.

Gjithashtu, SKR 2022-2029 është harmonizuar dhe reflekton qëllimet e politikave, objektivat specifike dhe masat e parashikuara në dokumentat/planet strategjike të këtyre ministrive në lidhje me zërat specifikë në strategjitë e tyre që kanë të bëjnë me rininë.

- **Agjenda kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2022-26** e miratuar me VKM nr. 659, datë 03.11.2021 "Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026"
- **Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm** e cila ka 17 objektiva për zhvillim të qëndrueshëm të cilat ndërlidhen me politikat rinore dhe plane specifike në të paktën 20 elemente të këtyre objektivave.
- **Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021 – 26** i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të plotë të të rinjve si brenda dhe jashtë shkollës duke krijuar mundësi për zhvillimin digjital në arsim dhe revolucionarizimin e orës së mësimit por edhe duke ndërtuar masa specifike për aktivitetet pas mësimit. Një zhvillim i rëndësishëm ishte edhe "Pakti për Universitetin," i njoftuar nga Kryeministri në dhjetor 2018, pas protestave masive të studentëve. Kjo përfshiu 11 VKM dhe 4 Urdhëresa Ministrore për të adresuar 8 kërkesa të formuluara dhe kërkuara nga studentët gjatë protestës.

[12] Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024 f. 407

- Shqipëria ka edhe një **Strategji Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin** që nga fundi i vitit 2017 me synime specifike angazhimin e të rinjve të proceset kërkimore shkencore dhe skemat e kërkimit shkencor në Evrope si Horizon 2020.
- **Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë** me një objektiv të veçantë për përmirësimin e drejtësisë për të mitur, e cila garanton një drejtësi miqësore ndaj të miturve, me qëllimin për të mbrojtur interesin e tyre më të lartë.
- Me **Strategjinë Anti-korrupsion** synohet bashkëpunimi me organizatat rinore për monitorimin e masave anti-korrupsion dhe ndërgjegjësimin kundër këtij fenomeni që në shkolla.
- **Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2021 - 26** ku theksohen zhvillimet në TIK dhe infrastrukturë digjitale për të mbështetur mësimin digjital dhe komunikimet elektronike dhe rritur cilësinë në arsim.
- **Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019 – 22** ku përveç rritjes së cilësisë dhe ofertës së arsimit e formimit profesional hapen një sërë programesh që mbështesin e nxisin punësimin e të rinjve. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ndërton mbi arritjet dhe mësimet e nxjerra në periudhën 2014-2018 dhe përfshin një sërë masash të bazuara në katër prioritete strategjike, të cilat konsiderohen të mbeten relevante për periudhën e ardhshme. Ajo synon një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që mbështetet tek "Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për gjithë femrat dhe meshkujt". Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të nxisë vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi për gjithë femrat dhe meshkujt shqiptarë gjatë të gjithë ciklit të jetës. Ky qëllim do të arrihet me veprimtari politike koherente dhe të bashkërenduara, të cilat njëkohësisht i përgjigjen kërkesës dhe ofertës për punë, si dhe sjellin mënjanimin e hendeqeve të përfshirjes sociale.
- **Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional** në Republikën e Shqipërisë po plotësohet me aktet nënligjore, shumica e akteve është miratuar dhe po përfundon miratimi dhe hartimi i akteve të mbetura. Qeveria së fundmi ka racionalizuar institucionet e AFP-së, duke krijuar Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe duke ristrukturuar më tej Agjencinë Kombëtare të AFP-së dhe Kualifikimeve. Në sistemin e AFP-së, tashmë është zhvilluar një cikël koherent politikash të proceseve të brendshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kualifikimeve profesionale, i cili mbështet përshtatshmërinë e kualifikimeve në tregun e punës.
- Nga Ministria e Kulturës është hartuar "**Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025**" dhe miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 903, Datë 24.12.2019 "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën, 2019–2025", dhe Plani i saj i Veprimit. Ky është dokumenti i parë i këtij lloji, me anë të cilit synohet konceptimi i një udhërrëfyesi për zhvillimin e sektorit të kulturës dhe trashëgimisë kulturore me qëllim të krijimit të kushteve të favorshme për zhvillim individual, social dhe shtetëror.
- **Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020–2023** synon që të luftojë pabarazitë socio-ekonomike, parashikimin e një sistemi që ka politikat dhe mekanizmat për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë ose të përjashtuar nëpërmjet programeve parandaluese dhe riintegrimit social alternuar me skemat e punësimit".
- **Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025** ka për qëllim të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë

diskriminimin dhe të eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre, sipas parimeve të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Strategjisë Evropiane për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Plani përmban qëllimin strategjik për sigurimin dhe ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.

- **Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020**, ka për synim heqjen e pengesave me të cilat përballen romët dhe egjiptianët sa i përket aksesit në shërbime dhe përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës, nëpërmjet integrimit dhe nxitjes së dialogut ndërkulturor.
- **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore** (SKBGJ) 2016–2020 [15] është konceptuar si një udhërrëfyes drejt një shoqërie të mundësive të barabarta e pa dhunë, në të cilën: nevojat e grave dhe burrave merren në konsideratë dhe trajtohen në mënyrë të barabartë; gratë respektohen, mbrohen, nxiten e mbështeten për të ecur përpara njëlloj si dhe burrat; vajzat e djemtë, rriten të lumtur e të gëzuar mes parimeve të barazisë e mos-diskriminimit - pra një shoqëri, që ka në bazë një familje të shëndoshë, komunitet mbështetës dhe institucione të konsoliduara që zbatojnë legjislacionin dhe detyrimet e tyre me përgjegjshmëri.
- **Ligji për start-up**, i miratuar në 2022, krijon mundësi për të rinjtë dhe gratë e reja si në trajnime ashtu edhe në mbështetjen e ideve të tyre për biznes.
- **Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 25** e ka në themel të saj bashkëpunimin me ministrinë përgjegjëse për rininë në çdo masë dhe aspekt të kësaj strategjie.
- Strategjitë që kanë një ndikim të rëndësishëm mbi rininë janë edhe dokumenti i Politikës së Përfshirjes Sociale, Planet Kombëtare të Veprimit për Romët dhe Egjiptianët, Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, si edhe plani veprimit për LGBTI që e sheh të integruar rininë në masat e parashikuara. Strategjia e shëndetit publik dhe atij mendor po ashtu kanë masa specifike të parapara për rininë.

Me qëllim rritjen e shërbimeve të dedikuara dhe miqësore për rininë në Shqipëri në përuthje me standardet më të mira evropiane, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka rakorduar në vijimësi punën për hartimin e kësaj Strategjie me kuadrin strategjik të të gjithë institucioneve të tjera.

2.5. Institucionet që merren me politika rinore të cilat janë ndërsektoriale dhe përfshijnë shumë aktorë në procesin e zbatimit të tyre:

- Qeveria qendrore
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët – është një institucion i krijuar me qeverinë e re të vitit 2021 dhe që ka peshën kryesore e themelore në organizmin dhe mbështetjen e rinisë. Ai është përgjegjës për politikën e përgjithshme rinore dhe kuadrin ligjor, monitorimin e zbatimit të politikave rinore dhe përfaqësimin e Qeverisë së Shqipërisë në nivel ndërkombëtar në lidhje me çështjet që lidhen me rininë.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit deri në vitin 2021 ka pasur edhe portofolin e rinisë dhe ishte përgjegjëse e plotë për politikat rinore. Një zëvendësministër i përkushtuar për Rininë ishte pjesë jetike e kuadrit të përgjithshëm të politikave për të rinjtë ndërsa

Drejtoria për Rininë në kuadër të kësaj ministrie ishte përgjegjëse për çështjet që lidhen me politikat rinore. Kjo ministri vazhdon të ketë një rol të rëndësishëm në politika rinore sepse mban përgjegjësi për dy fusha të rëndësishme në jetën e të rinjve 15 – 29 vjeç, siç janë arsimi dhe sporti.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për sipërmarrjen rinore, AFP-në dhe inovacionin.
- Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për raportet e të miturve në konflikt me ligjin[13].
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MHSP) është përgjegjëse për shëndetin e të rinjve dhe përfshirjen sociale.
- Ministria e Kulturës është përgjegjëse për artin dhe politikat kulturore që synojnë edhe rininë.
- Organet e administratës shtetërore;
- Organet e vetëqeverisjes lokale;
- OJF-të;
- Parlamentet e studentëve/nxënësve dhe subjekteve të tjera juridike me qëllim të përmirësimit të statusit të të rinjve, zhvillimit të tyre personal dhe social, si dhe përfshirjes së tyre në çështjet sociale.

2.5.1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Bashkitë, sipas ligjit për rininë, kanë tashmë një punonjës të specializuar për çështjet rinore. Ato po ashtu, në varësi të madhësisë së tyre, zakonisht kanë një Drejtori ose Njësi për Shërbimet Sociale, ku përfshihen përgjegjësitë për çështjet që lidhen me rininë. Në nivel lokal, qendrat rinore janë një platformë thelbësore për fuqizimin e të rinjve. Qendrat rajonale rinore ekzistojnë në Korçë, Shkodër dhe Vlorë. Qendrat rinore deri më sot funksionojnë kryesisht si mjedise për organizimin e eventeve të projekteve nga OJF-të, e jo si platforma për pjesëmarrje aktive të të rinjve.

2.5.2. Organizatat jofitimprurëse rinore dhe OJF-të

e tjera që punojnë me të rinjtë janë aktorë thelbësorë në terren dhe ato shpesh shërbejnë për të mbushur boshllëkun në çështjet e të rinjve që nuk mbulohen nga institucionet publike. Ligji për Rininë bën dallimin ndërmjet 'organizatave rinore' dhe 'organizatave për rininë'. Ligji për Rininë i përkufizon organizatat rinore si "persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për OJF-të, objekt aktiviteti i të cilave është përfaqësimi, mbrojtja dhe zhvillimi i interesave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse". Ndërsa organizatat për të rinjtë janë "persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për OJF-të, të cilat në fushën e tyre të veprimtarisë synojnë gjithashtu mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve dhe që kanë përvojë në zbatimin e programeve me ndikimpër të rinjtë."

[13]. **Shënim shpjegues**: Në përputhje me Kodin e Drejtësisë penale për të mitur, ministria e drejtësisë është përgjegjësie për të miturit në konflikt me ligjin penal – pra, jo çdo raporti i të miturve me ligjin është përgjegjësi e MD, por vetëm kur të miturit kryejnë vepra penale. Në këtë kuadër, përgjegjësia e MD shtrihet me marrjen e masave për promovimin e riintegrimit të të miturit në konflikt me ligjin penal dhe që i mituri të luajë në shoqëri një rol sa më të dobishëm apo edhe garantimin e rishoqërizimit dhe rehabilitimit të të miturit që ka kryer vepër penale

2.6. Zhvillimi i një strategjie kombëtare për rininë në lidhje me Garancinë Rinore të BE-së

Në kuadër të **kapitullit 19**, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është në procesin e hartimit të një skeme për Garancinë Rinore (Youth Guarantee) në Shqipëri. Garancia Rinore është një angazhim nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE, për të siguruar që të gjithë të rinjtë nën moshën 29 vjeç marrin një ofertë cilësore brenda një periudhe katër mujore të rregjistrimit si punëkërkues të papunë, ose të braktisjes së arsimit formal, për programet e mëposhtme:

- Punësim;
- Edukim të vazhdueshëm (continued education);
- Mësim profesioni (apprenticeship);
- trajnim profesional.

Të gjitha vendet e BE-së, janë angazhuar për zbatimin e Garancisë Rinore në zbatim të Rekomandimin e Këshillit (Prill 2013). Nevoja për një program të tillë në BE erdhi për arsye të rritjes së papunësisë rinore dhe sidomos të atyre që u përkasin grupit të rinj as në punësim, arsim apo aftësim APAA[14] (NEET not in employment, education or training). Kjo iniciativë e BE-së, po shtrihet në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor, ku bën pjesë dhe Shqipëria. Si në të gjitha vendet e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor edhe në Shqipëri arsyeja e prezantimit të këtij programi është, mbështetja e APAA, pasi shkalla e APAA për Shqipërinë në 2020 ishte 27.9, nga 26.6 në 2019 (INSTAT), më shumë se dyfishi i mesatares së BE-27 (12.6%). Në këtë grup, 36.5% janë klasifikuar si të papunë (INSTAT 2020). Vetëm rreth 18,000 të rinj APAA - nga gjithsej mbi 190,000 - janë regjistruar në zyrat e punësimit dhe mbulimi i nevojave duhet të shtrihet përtej këtij grupi, që përfaqëson më pak se 10% të të rinjve APAA.

Garancia Rinore në Shqipëri do të bazohet në një grup pune ndërinstitucional dhe të një grupi teknik për hartimin e planit kombëtar të garancisë rinore, si dhe përcaktimin e koordinatorit kombëtar. Këto grupe pune do të veprojnë sipas Udhëzuesit të Bashkimit Evropian për "Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor – Udhëzime për Garancitë Rinore" dhe do të jenë përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar të Garancisë Rinore.

Hartimi i skemës së Garancisë Rinore është parashikuar në planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019 -2022. Ky proces është duke u mbështetur dhe nga BE, ILO dhe do të përfshijë pra, dy grupe pune në nivel politik dhe teknik, të përbërë nga institucione shqiptare siç janë Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, por dhe institucione të tjera siç janë Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia

[14] APAA – As në Punësim, Arsim apo Aftësim (NEET not in employment, education, or training).

Kombëtare e Rinisë etj. Në këto dy grupe pune do të ketë përfaqësues të partnereve sociale, përfaqësues të organizatave të të rinjve, pushtetit vendor etj.

Grupi ndërinstitucional i punës kryesohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe në përbërje të tij ka përfaqësues nga zyra e Kryeministrit, ministritë e linjës, nga institucionet e varësisë, shoqëria civile dhe përfaqësues të organizatave ombrellë rinore të përmendura më sipër. Grupi ndërinstitucional i punës është përgjegjës për dhënien e udhëzimeve dhe mbikëqyrjes së procesit të hartimit të skemës së Garancisë Rinore në Shqipëri, shqyrton Planin Kombëtar të Garancisë Rinore dhe e monitorn atë.

3. Deklarata e Vizionit

3.1 Vizioni

Duke marrë në konsideratë zhvillimet e deritanishme vizioni për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 është:

Strategjisë kombëtare 2022 – 2029 ju jep mundësi dhe mbështet të rejat dhe të rinjtë për t'u bërë partnerë aktivë në zhvillimin e Shqipërisë.

Misioni i kësaj strategjie është:

Rritja dhe përmirësimi i mundësive, shërbimeve, dhe mbështetjes për të rinjtë dhe në bashkëpunim me të rinjtë në Shqipëri

Kjo strategji bazohet në parimet e mëposhtëme:

- Mbështetje për të gjithë të rinjtë për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë, duke marrë parasysh të drejtat e tyre, zërat dhe nevojat e tyre të ndryshme, duke mos lënë askënd pas.
- Qasje e bashkërenduar për ofrimin dhe shpërndarjen e shërbimeve për të rinjtë, bazuar në dialogun ndërministror/ndërsektorial dhe shumëpalësh, me fokus të veçantë në zonat rurale, vajzat e reja dhe grupet e margjinalizuara të të rinjve.
- Monitorim dhe vlerësim i orientuar drejt nxjerrjes së mësimeve
- Të rinjtë si partnerë kyç në zhvillim si në nivel kombëtar dhe atë vendor.
- Pjesëmarrja domethënëse e të rinjve në vendim-marrjen lokale dhe kombëtare, në organizatat rinore dhe jetën e komunitetit.
- Krijimi i politikave rinore të bazuara në të dhëna dokumentare e statistikore të mbështetura me buxhet specifik të dedikuar për të rinjtë dhe dispozita të tjera buxhetore sektoriale.

Vizioni synohet të jetësohet përmes 3 qëllimeve të politikës:

- **Qëllimi i politikës 1:** Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar

- **Qëllimi i politikës 2:** Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.
- **Qëllimi i politikës 3**: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)

Lidhja midis vizionit, qëllimeve të politikës, objektivave specifikë dhe rezultateve paraqitet në figurat më poshtë:



Figura 1: Lidhja mes vizionit dhe qëllimit të politikave të SKR-së



Figura 2: Lidhja mes qëllimeve të politikave dhe objektivave specifike të SKR-së

3.2 Treguesit kyç të performancës

Tabela 1. Treguesit kyç të performancës për SKR 2022-29

Lloji i treguesit	**Emërtimi i Treguesit të Performancës**	**Lidhja me Qëllimin e Politikës**	**Institucioni Përgjegjës**	**Baseline** 2021	**Target 2029**
Nivel i Lartë/ Impakti	Indeksi botëror i zhvillimit të rinisë	E lidhur me tre qëllimet	Tregues në nivel botëror/ CommonWealth	0.764 Vendi 55 nga 181	0.8 Vendi 35
Rezultati	Indeksi i Progresit të të Rinjve	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Forumi Evropian i të Rinjve	68.49/100 Vendi 64/163	55/100 Vendi 50
Ndikimi	% e të rinjve që raportojnë se ndihen të përfaqësuar në politikat rinore të zbatuara në nivel qëndror/vendor	Fuqizimi i organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore "Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar"	MSHRF	20%	80%
Rezultati	% e buxhetit të shtetit dedikuar për programet mbi rininë	Fuqizimi i organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore "Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar"	MSHRF/ MFE/ AKR	0.05%	2.4%

PJESA II – QËLLIMET E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË SKR 2022-2029

Qëllimi i Politikës 1: Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar.

Përmes fuqizimit, organizimit rinor dhe rritjes së pjesëmarrjes rinore kjo politikë, synon të arrijë tre objektivat e mëposhtëm:

Objektivi Specifik 1.1: Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike

Objektivi Specifik 1.2: Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.

Objektivi Specifik 1.3: Studimet rinore zhvillohen dhe bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.

Institucionet Drejtuese

MSHRF, AKR

Institucioni Pjesëmarrës

MEF, MAS, INSTAT, AKSHI, AKPA, KQZ, AKAFPK, IAL

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur rezultatet specifike janë përshkruar në planin e veprimit të dokumentit strategjik që do të ngarkohet në IPSIS.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i Politikës Nr.1 synon ngritjen dhe bërjen funksionale të një sistemi të plotë mbështetës dhe organizativ për rininë në të gjithë vendin duke ju krijuar mundësi të rinjve dhe të rejave të shprehen dhe të kontribuojnë efektivisht në jetën dhe zhvillimin e komuniteteve të tyre. Ky qëllim i politikës lidhet me OZHQ-të 5, 11, 13 dhe 16, të cilat promovojnë një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse që garanton zhvillim të qëndrueshëm dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Duke e vënë theksin te rritja e pjesëmarrjes së të rejave në proceset zgjedhore kjo politikë nxit barazinë gjinore. Nga ana tjetër me ndërgjegjësimin e rinjve për vullnetarizëm synohet të rritet veprimi i të rejave dhe të rinjve për klimën.

Kjo politikë ka lidhje edhe me PKIE 2022-24 veçanërisht në masat që ka parashikuar qeveria për forcimin e dremokracisë dhe shtetit të së drejtës që në kuadër të kësaj strategjie përkthehet në forcimin e organizatave rinore, rrjetëzimin e tyre dhe lehtësimin e kushteve për të krijuar organizata rinore.

Në lidhjet me MSA kjo politikë lidhet drejtpërsëdrejti me Titullin VII që trajton çështjet e Lirisë, Drejtësisë dhe Sigurisë si edhe me nenin 78 kur zhvillon masa për fuqizimin e institucioneve rinore, nenin 99 në kuadër të masave për bashkëpunimin mes organizatave rinore për të përmirësuar komunitetet dhe rritur përfshirjen, si edhe nenin 111 në lidhje me masat e forcimit të Agjencisë Kombëtare Rinore për të zbatuar politikat rinore si edhe në krijimin e një fryme miqësore kundrejt të rejave dhe të rinjve në kontaktet e tyre me administratën.

Objektivat e kësaj strategjie përputhen edhe me SKZHI në arritjet e objektivit strategjik të paraqitur në këtë dokument në lidhje me rininë që synon nxitjen dhe thellimin e pjesëmarrjes së të rinjve në shoqëri e vendim-marrje.

Treguesit e rezultateve për Qëllimin e Politikës 1 janë përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Treguesit e rezultateve për Qëllimin e Politikës 1

Lloji i treguesit	**Emërtimi i Treguesit të Përformancës**	**Lidhja me Qëllimin e Politikës**	**Lidhja me Objektivin Specifik**	**Institucioni Përgjegjës**
Rezultati	% e bashkive ku janë ngritur Qëndrat Rinore Multifunksionale	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF/ AKR
Rezultati	Numri/përqindja i/e bashkive që kanë ngritur kënde digjitale të informimit rinor (info-points)	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	MSHRF/ AKR/ Bashki
Rezultati	Numri i Këshillave Vendore të ngritur dhe funksionale (në nivel bashkie)	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të	Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe	MSHRF/ AKR/ Bashki

		fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	
Rezultati	Ligji "Për Rininë" i rishikuar dhe miratuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF
Rezultati	Ligji "Për Vullnetarizmin" i rishikuar dhe miratuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF/AKPA/MFE
Rezultati	Platforma rinore "Të rinjtë për të rinjtë" e ngritur, funksionale dhe e përditësuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	MSHRF/ AKR
Rezultati	Politikat zhvillimore rinore të hartuara bazuar në analizë	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore	Studimet rinore zhvillohen dhe bëhen pjesë e programeve të studimit në	MSHRF/ AKR

		Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.	

*Matrica e Qëllimit të Politikave, Objektivat Specifike dhe Indikatorët janë dhënë në Aneksin 3 të Planit të Veprimit.

Objektivi Specifik 1.1:

Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Në të gjitha takimet konsultative që janë bërë nga përfaqësuesit e qeverisë me të rinj në kuadër të zhvillimit të kësaj strategjie, mungesa e informacioneve të përditësuara dhe saktësia e tyre kanë dalë në plan të parë. Të rinjve janë po ashtu të paorientuar se ku mund të kërkojnë informacione për t'u zhvilluar më tej apo fituar përvojë profesionale e vullnetare si për burimet digjitale online ashtu edhe për informacionet që duhet të ndahen në mjediset e tyre si shkolla, vendet e punës apo vendet e argëtimit.

Në zbatim të Ligjit për Rininë janë emëruar nëpunësit rinorë nëpër të gjitha bashkitë por Këshillat Vendorë Rinorë nuk janë efektivë në të gjitha bashkitë. Organizimi rinor, veçanërisht jashtë kryeqytetit dhe jashtë organizimive shkollore nuk i përgjigjet situatave dhe sfidave që kajonë të rinjtë. Organizimi rinor në kuadër të organizatave jo-qeveritare është gjithashtu i vështirë për t'u realizuar për shkak të pagesave të larta që e shoqërojnë regjistrimin e një organizate jo-qeveritare dhe mungesës së përvojës nga ana e të rinjve në këtë proces. Edhe organizimet rinore në shkolla janë kryesisht formale dhe nuk i fuqizojnë të rinjtë.

Në këtë situatë, është parë me përparësi, rishikimi i ligjit të rinisë në tërësinë e tij dhe në veçanti për të rritur rolin e të rinjve në përmirësimin dhe zhvillimin e jetës në komunitet dhe për t'i bërë të rejat dhe të rinjtë aktivë në ndërmarrjen e politikave rinore vendore. Shembut e mirë të analizës së pjesëmarrjes së të rinjve në proceset buxhetore dhe vendime të tjera vendore në bashkitë Cërrik, Korçë, Fier, Përmet, Durrës, Roskovec, Belsh, Shijak, Urë Vajgurore, Krujë dhe Pogradec duhen shtrirë në të gjithë vendin[15].

Takimet me të rinjtë kanë nxjerrë në pah edhe nevojën për një komunikim më efektiv me ta në platformat e komunikimit që përdoren më së shumti prej tyre. Konceptet e komunikimit digjital me të rinjtë si për të informuar ata për mundësitë për përfshirje, vullnetarizëm apo punësim apo edhe për të krijuar rrjete të përbashkëta komunikimi mes tyre duhen rishikuar. Kërkohet zhvillimi apo rikonceptimi i faqes "rinia.al" për të fuqizuar komunikimin mes të rinjve dhe për të lidhur të gjitha platformat dhe nismat rinore që ekzistojnë.

Jo vetëm infrastruktura digjitale por edhe ajo fizike në shërbim të të rinjve mbetet problematike dhe sfiduese. Me përjashtim të një numri të paktë të qendrave rinore kërkohet shtimi i tyre në të gjithë vendin dhe mundësisht në nivel bashkie, duke krijuar hapësira të përshtatshme për të rinjtë. Sigurimi i infrastrukturës për aktivitete rinore do të rriste dhe promovonte veprimtarinë rinore dhe do të siguronte një bazë për zhvillime të mëtejshme për rininë si në çështjet e ndërgjegjësimit të tyre politik, vetëshprehjes dhe provomimit e zhvillimit të punës rinore.

[15] Informacion bazuar në analizat e pjesëmarrjes së të rinjve në buxhetim në nivel vendor realizuar nga Observatori për të Drejtat e Femijëve dhe të Rinjve mbështetur nga OKB në Shqipëri.

Institucionet Drejtuese

MSHRF, AKR. MAS

Institucionet Pjesëmarrës

AKPA, njësitë e qeverisjes vendore, KQZ,

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur rezultatet specifike janë përshkruar në planin e veprimit të dokumentit strategjik që do të ngarkohet në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me nën-kapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së.

Objektivi Specifik 1.1 synon aktivizimin e të rinjve në jetën social-ekonomike të vendit përmes informimit më të mirë të tyre për zhvillimet dhe duke i bërë ata pjesë aktive të procesve të informimit dhe pjesëmarrjes në jetën social-politike të vendit. Ky objektiv lidhet me me nenin 100 që trajton çështjet e arsimit dhe trajnimit të të rinjve sepse synon aftësimin e të rinjve për të marrë informacionet në lidhje me punësimin, aftësimin dhe edukimin përmes burimeve digjitale të informacionit. Po ashtu ky objektiv lidhet edhe me me nenin 77 të kapitullit të V në diskutimet e punësimit për të rejat dhe të rinjtë si edhe me nenin 103 që lidhet me shoqërinë e informacionit pasi ky objektiv synon digjitalizimin e proceseve të shkëmbimit të informacioneve që i duhen të rinjve për zhvillimin e tyre profesional dhe shoqëror.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 3: Lista e treguesve kyç të performancës lidhur me objektivin specifik 1.1

Lloji i treguesit	Emërtimi i Treguesit të Përformancës	Lidhja me Qëllimin e Politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni Përgjegjës
Rezultati	% e bashkive ku janë ngritur Qëndrat Rinore Multifunksionale	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF/ AKR
Rezultati	Numri i Këshillave Vendore të ngritur dhe	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore	Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë	MSHRF/ AKR/ Bashki

	funksionale (në nivel bashkie)	Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	
Rezultati	Ligji "Për Rininë" i rishikuar dhe miratuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF
Rezultati	Ligji "Për Vullnetarizmin" i rishikuar dhe miratuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF/AKPA/MFE

Lista e masave për arritjen e Objektivit Specifik 1.1:

Tabela 4: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.1

Nr masës	**Masa sipas objektivit specific 1.1**

1.1.1	Rishikohet Ligji për Rininë për të konsoliduar dhe zhvilluar më tej proceset e krijimit të organizatave rinore, përfaqësimin rinor, punën rinore[16] dhe ofrimin e shërbimeve të pranueshme e miqësore për të rinjtë.
1.1.2	Forcohen mekanizmat (në nivel qendror dhe vendor) për të garantuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e të rejave dhe të rinjve në vendim-marrje.
1.1.3	Përmes platformës rinore "Të rinjtë për të rinjtë" dhe formave të tjera të komunikimit social shpërndahen informacione dhe udhëzues për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje.
1.1.4	AKR mbështet me anë të një programit grantesh organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes ngritjes së infrastrukturës për qendra rinore dhe hapësira për të rinjtë.
1.1.5	Nxitet zhvillimi i një mjedisi shkollor përkrahës për të gjithë nxënësit dhe mbështetet aktivizimi i Këshillave Studentore / Qeverive të Nxënësve dhe organizimeve të tjera të nxënësve[17].
1.1.6	Rritet ndërgjegjësimi politik i të rinjve dhe në veçanti i vajzave dhe grave të reja, nëpërmjet promovimit të programeve të edukimit të votuesve dhe nismave të tjera ndërgjegjësuese.
1.1.7	Promovohet dhe mbështetet e drejta e të rejave dhe të rinjve për ***vetë-shprehje*** në lidhje me orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor.
1.1.8	Rishikohet ligji "Për vullnetarizmin" me qëllim fuqizimin e mundësive për vullnetarizmin e të rejave/rinjve).
1.1.9	Në përputhje me ligjet dhe VKM për njohjen e përvojës së punës dhe mësimit informal dhe jo-formal njihen kompetencat e fituara nëpërmjet edukimit jo formal dhe punës rinore bazuar në përcaktimet e profesioneve të punës së të rinjve nëpërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe në bashkërendim me Portofolin Evropian të Punës Rinore (European Youth Work Portfolio).

Detajimi i plotë e masave është dhënë në planin e veprimit IPSIS.

[16] (punën në organizata rinore dhe në organizata të tjera nga të rinjtë)

[17] *në përputhje me nenin 36 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar*

Objektivi Specifik 1.2:

Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Ligji për Rininë i vitit 2019, parashikonte edhe zhvillimin e një institucioni i cili do të ishte përgjegjës për zbatimin e politikave rinore. Ky institucion është Agjencia Kombëtare Rinore, aktiviteti i së cilës rregullohet si me ligjin për rininë ashtu edhe me një grup vendimesh qeveritare (VKM). Aktualisht ky institucion bën zbatimin e politikave rinore dhe menaxhon proceset e dhënies së granteve për organizatat rinore. Në 2022, buxheti i AKR-së është 211370 mijë leke, dhe përfaqëson pak më shumë se 0.05% të buxhetit të shtetit të këtij viti. AKR, për t'iu përgjigjur sfidave të zhvillimit rinor dhe për të nxitur zbatimin e politikave me te rejat e të rinjtë në qendër të tyre duhet fuqizuar si me personel ashtu edhe me fonde.

Sipas raportit me zbatimin e politikave të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015 –2020 e kanë lidhur shkallën e realizimit të këtij plani që shkon deri në masën 40% edhe me mungesën e burimeve njerëzore për rininë[18]. Fuqizimi i burimeve njerëzore dhe fuqizimi i organizatave rinore do të rriste edhe përfaqësimin më cilësor të rinisë në rajon e më gjerë duke ndërtuar edhe mbi përvojat pozitive të zbatimit të politikave të programit "Tirana – kryeqyteti evropian i rinise" dhe mbi mbështetjen e dhënë për këtë program nga qeveria.

Lidhur ngushtë me këtë gjë është edhe zhvillimi i kapaciteteve në administratën publike për t'u marrë me politikat rinore si nëpër ministritë e linjës ashtu edhe në nivel vendor. Forcimi i kapaciteteve brenda administratës për t'iu përgjigjur kërkesave të të rejave dhe të rinjve me zbatim politikash për ta duke siguruar edhe shërbime miqësore kundrejt tyre mbetet ende një sfide edhe pse ekziston nisma që një e treta e vendeve të punës në administratën publike duhet të përmbushen nga të rinjtë.

Edhe pse janë bërë hapa të mëdha përpara për angazhimin e të rejave dhe të rejave pranë proceseve politikë-bërëse si me anë të stazheve profesionale apo kontratave të punësimit[19] çështjet e marrjes dhe dhënies së informacioneve në lidhje me programet e punësimit apo nxitjes së punësimit mbeten problematike. Kjo në një kohë kur qeveria ka marrë një sërë masash dhe politikash për të nxitur punësimin dhe inovacionin mes të rejave dhe të rinjve, politika që nga të rinjtë dhe të rejat që morën pjesë në konsultimet e bëra me ta në kuadër të kësaj strategjie nuk njiheshin.

Institucione drejtuese

MSHRF, AKR,

Institucionet pjesëmarrëse

MFE----------

[18] Për më tepër shiko kapitullin V "Gjetje dhe Rekomandime" të "Raportit Final i Vlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015 – 2020" botuar në Qershor 2020 me mbështetjen e UNFPA-së dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

[19] Mbi 3000 mijë të rinj kanë bërë praktika pune në administrate dhe 1000 prej tyre kanë marrë kontrata punësimi që prej vitit 2015. Për më shumë shiko: 1/3 e vendeve në administratën publike i dedikohet punësimit të të rinjve (dap.gov.al)

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur rezultatet specifike janë përshkruar në planin e veprimit të dokumentit strategjik që do të ngarkohet në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me MSA-në.

Objektivi Specifik 1.2 synon fuqizimin e organizimit të administratës rinore që merret me rininë – Agjencinë Kombëtare Rinore më specifikisht për t'iu përgjigjur zhvillimeve të vrullshme dhe sfidave të kohës. E parë nga ky këndvështrim, ky objektiv specifik lidhet drejtëpërsëdrejti me Titullin VII të MSA, neni 78 i cili fokusohet në forcimin e institucioneve publike dhe në këtë rast lidhet me forcimin e organizimit të rinisë brenda administratës. Po ashtu kjo lidhet me titullin VIII të MSA-së dhe nenin 111 që fokusohet te forcimi i administratës publike.

Ky objektiv, i cili, kërkon zhvillimin e shërbimeve miqësore kundrejt rinisë lidhet edhe me OZHQ 16 në kontekstin e krijimit e institucioneve të forta i cili në këtë rast përkthehet në fuqizimin të mëtejshëm të kapaciteve zbatuese, administrative e drejtuese të AKR-së.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 5: Lista e treguesve kyç të performancës lidhur me objektivin specifik 1.2.

Lloji i treguesit	Emërtimi i Treguesit të Përformancës	Lidhja me Qëllimin e Politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni Përgjegjës
Rezultati	Numri/përqindja i/e bashkive që kanë ngritur kënde digjitale të informimit rinor (info-points)	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	MSHRF/ AKR/ Bashki
Rezultati	Platforma rinore "Të rinjtë për të rinjtë" e ngritur, funksionale dhe e përditësuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore	Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre	MSHRF/ AKR

		janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	

Tabela 6: Lista e masave të parashikuara në lidhje me Objektivin Specifik 1.2

Nr i masës	**Masa sipas objektivit specifik**
1.2.1	Fuqizohen rolet zbatuese, koordinuese, monitoruese të AKR përmes fuqizimit të saj me burime financiare dhe njerëzore për të siguruar zbatimin e politikave sektoriale për rininë të pasqyruara në këtë strategji.
1.2.2	Përmes AKR sigurohen fonde për rritjen e prezencës së Shqipërisë në proceset e politikëbërjes rinore si në nivel rajonal, evropian dhe global.
1.2.3	Bazuar në konceptin "Të rinjtë për të rinjtë" zhvillohen dhe aplikohen shërbime të informacionit për të rinjtë dhe rininë. Në këtë portal krijohet një platformë mes ofruesve formalë dhe jo-formalë të të mësuarit, bizneseve dhe agjencive të punësimit, për të përmirësuar mundësitë për punësimin e të rinjve.
1.2.4	Fuqizohen kapacitetet e politikë-bërësve dhe nëpunësve civilë në fushën e rinisë dhe zbatimin e politikave rinore bazuar në konceptin e shërbimeve miqësore dhe të pranueshme nga të rejat dhe të rinjtë dhe forcohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e politikave rinore

Objektivi Specifik 1.3:

Studimet rinore zhvillohen dhe bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Mbetet sfidë në vete nxjerrja e të dhënave statistikore të sakta për rininë të cilat nuk japin të dhëna vetën në rang vendi por të zbërthyera (disagreguara) për çështje të ndryshme që lidhen me rininë në nivel qarku apo bashkie. Edhe mungesave e databazave për organizatat rinore që kërkohet nga ligji për rininë shton paqartësinë e të dhënave.

Në kuadër të punës kërkimore për këtë strategji u vu re mungesa e studimeve rinore si njësi akademike në kërkimin shkencor dhe në IAL. Procesi i kërkimit për rininë dhe problemet e të rejave dhe të rinjve nuk mungojnë por ato janë të shpërndara dhe jo të orientuara për të nxitur vendim-marrje specifike. Procesi i kërkimit shkencor për rininë bëhet nga organizata rinore që mbështeten nga donatorë të ndryshëm. Studimet rinore janë të shpërndara kryesisht në degët e studimit të shkencave sociale dhe nuk i paraprijnë procesve politikë-bërëse.

Edhe zhvillimi profesional i burimeve njerëzore që merren me rininë nuk është i rregulluar apo i orientuar drejt IAL-ve, ku sipas të dhënave, në universitetet publike, ekziston vetëm një program masteri ekzekutiv që ka në qendër përgatitjen e këshilluesve për karrierë[20].

Institucionet Drejtuese

- MSHRF, AKR

Institucionet Pjesëmarrës

- MiSHMS, INSTAT

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur rezultatet specifike janë përshkruar në planin e veprimit të dokumentit strategjik që do të ngarkohet në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me nën-kapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së.

Objektivi Specifik 1.3 synon fuqizimin dhe konsolidimin e të dhënave dhe studimeve për rininë për të realizuar vendim-marrje të informuar dhe të lidhur me zhvillimin e rinisë si në nivelin qendror ashtu edhe në në atë vendor. Ky objektiv lidhet me Titullin VIII të MSA-së që trajton politikat e bashkëpunimit dhe më specifikisht me nenin 109 që trajton çështjet e bashkëpunimit në kërkimin shkencor. Zhvillimi i "studimeve rinore" sipas masave të këtij objektivi do të kërkojë bashkëpunim të institucioneve kërkimore dhe shkencore në vend, si edhe bashkëpunim në nivel evropian përmes programeve Horizon dhe Erasmus për të kontrinuar në zhvillimin e kapaciteteve në këtë fushë. Për më tej ky objektiv lidhet edhe me nenin 88 të Titullit VIII që ka të bëjë me bashkëpunimin statistikor. Zhvillimi i statistikave rinore dhe mundësitë për t'i

[20] Program i masterit ekzekutiv i Departamentit të Psikologjisë në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës që mbështetet nga Bashkëpunimi Zviceran i Zhvillimit.

zbërthyer ato në bazë të çështjeve themelore të studimeve rinore parashikohen si masa brenda këtij objektivi.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 7:Treguesit Kyç të Performancës në lidhje me Objektivin specifik 1.3

Lloji i treguesit	Emërtimi i Treguesit të Përformancës	Lidhja me Qëllimin e Politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni Përgjegjës
Rezultati	Politikat zhvillimore rinore të hartuara bazuar në analizë	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar	Studimet rinore zhvillohen dhe bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.	MSHRF/ AKR

Lista e masave të nevojshme për arritjen e objektivit specifik 1.3

Nr	Lista e masave sipas objektivit specifik
1.3.1	Krijohen baza të dhënash statistikore dhe studimore për rininë në Shqipëri përmes forcimit të kërkimit shkencor rreth rinisë si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe fuqizohet studimi i rinisë si fushë akademike dhe shkencore
1.3.2	Politikat zhvillimore rinore ndërtohen mbi analiza faktike dhe dokumentare
1.3.3	Në përputhje me Ligjin për Rininë dhe VKM-të zhvillohet baza e të dhënave për organizatat rinore dhe për rininë duke përfituar edhe nga proceset e digjitalizimit të shërbimeve publike.

Tabela 8:Lista e masave për zbatimin e objektivit specifik 1.3

Qëllimi i Politikës 2:

Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

Ky qëllim politik synon të arrijë novacionin, edukimin, autonominë, dhe barazinë e drejtë për të rejat dhe të rinjtë përmes objektivave të mëposhtëm:

Objektivi Specifik 2.1: Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive

Objektivi Specifik 2.2: Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuari cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.

Objektivi Specifik 2.3: Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësimin, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemit arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.

Institucionet përgjegjëse drejtuese janë MSHRF, AKPA, AKR.

Ndërkohë institucionet kryesore pjesëmarrëse janë MAS, MiSHMS, MFE, AKSHI, RASH, AKCESK dhe AKAPFK

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuara janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i Politikës 2 përcaktohet në kushtet që të rejat dhe të rinjtë duhet të kenë në një vend si Shqipëria për t'u angazhuar dhe zhvilluar me anë të novacionit dhe arsimit cilësor e per pasojë edhe duke e rritur profesionalizmin dhe cilësinë e punësimit të tyre. Kjo politikë adreson autonominë rinore dhe dhënien e mundësive përtej shanseve të barabarta për të mënjanuar pabarazitë dhe mënjanimin sociale. Nga kjo pikë vështrimi, ky objektiv specifik lidhet ngushtë me OZHQ-të 4 dhe 8 të cilat kanë të bëjnë respektivisht me arsimin cilësor dhe punësimin e denjë. Të dhënat para-pandemike dhe para tërmetit të vitit 2019 tregojnë se ka shumë për të bërë në lidhje me fuqizimin e cilësisë në arsim e në veçanti në lidhje me proceset e këshillimit për punësim dhe karrierë.

OZHQ 4 - EDUKIM CILËSOR	BURIMI	VITI	TË DHËNAT
4.1.1 (1) Përqindja e fëmijëve në fund të arsimit të mesëm të ulët, të paktën me një nivel minimal të aftësisë në lexim *Meshkuj 37.9 Femra 58*	PISA / OECD / Përllogaritje të Bankës Botërore	2018	48
4.1.1 (2) Përqindja e fëmijëve në fund të arsimit të mesëm të ulët, të paktën me një nivel minimal të aftësisë në matematikë *Meshkuj 55.9 Femra 59.4*	PISA / OECD / Përllogaritje të Bankës Botërore	2018	58
4.1.2 (1) Shkalla e përfundimit të arsimit në fillore *Meshkuj 94.16 Femra 95.7*	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / Përllogaritje të UNICEF	2018	94.92
4.1.2 (2) Shkalla e përfundimit të arsimit të mesëm të ulët *Meshkuj 97.93 Femra 97.41*	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / Përllogaritje të UNICEF	2018	97.67
4.1.3 (3) Shkalla e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë *Meshkuj 76.23 Femra 79.86*	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / Përllogaritje të UNICEF	2018	77.95
4.2.1 (1) Përqindja e fëmijëve (36-59 muajsh), me zhvillimin e duhur shëndetësor, mësimor dhe psiko-social			I pamatur
4.2.2 Shkalla e pjesëmarrjes në të mësuarin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të hyrjes në fillore; 5-6 vjeç) *Meshkuj 91.5 Femra 86.7*	Ministria e Sportit Arsimit dhe Rinisë / INSTAT	2019	89.1
4.3.1 Raporti i pjesëmarrjes së të rinjve (15-24 vjeç) në trajnime formale dhe jo formale në 4 javët e fundit *Meshkuj 47 Femra 56.1*	Anketa e Forcave të Punës / INSTAT	2019	51.5
4.4.1 Përqindja e popullsisë (16-24 vjeç) ka të paktën një aftësi në Teknologji Informacion dhe Komunikimi (TIK) *Meshkuj - 20.9 Femra - 20.6*	Anketimi i Përdorimit të Teknologji Informacion dhe Komunikimi (TIK) / INSTAT	2019	41.5
4.5.1 (1) Treguesi barazisë gjinore për pjesëmarrjen në arsim e ulet	Ministria e Sportit Arsimit dhe Rinisë / INSTAT	2019	0.95
4.5.1 (2) Treguesit e barazisë gjinore për pjesëmarrjen në arsimin e mesëm të ulët	Ministria e Sportit Arsimit dhe Rinisë / INSTAT	2019	0.94

Figura 3: Të dhënat për edukim cilësor sipas botimit të UNICEF dhe INSTAT "Treguesit e Mirëqënies së Fëmijeve dhe Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri 2016-19" f. 19

Mungesa e të dhënave të sakta në lidhje me punësimin, siç vihet re edhe në tabelën në vijim, thekson edhe një herë rëndësinë që ka mbledhja e të dhënave të sakta statistikore për çdo fushë që ka të bëjë me rininë dhe zhvillimin e saj. Planet dhe programet që lidhen me Garancinë Rinore dhe zhvillimi e nxitja e punësimit rinor do të ndikonin drejtëpërsëdrejti në përmirësimin e situatës me OZHQ 8 dhe do të përbënin një bazë të fortë për të ulur migrimin dhe rritur punësimin e të rinjve brenda vendit.

OZHQ 8 - PUNË DINJITOZE DHE RRITJE EKONOMIKE	BURIMI	VITI	TË DHËNAT
8.6.1 Raporti i të rinjve (15-24 vjeç) jo të shkolluar, të punësuar ose të trajnuar *Meshkuj - 25.8 Femra - 25.3*	Anketa e Forcave të Punës / INSTAT	2019	25.5
8.7.1 (1) Përqindja e fëmijëve (5-17 vjeç), që punojnë aktivitete ekonomike dhe punë shtëpie *Meshkuj - 3.6 Femra - 3.0*	Anketa e Punës së Fëmijëve në Shqipëri / INSTAT / ILO	2010	3.3
8.7.1 (2) Përqindja e fëmijëve (5-17 vjeç), që punojnë aktivitete ekonomike *Meshkuj - 3.4 Femra - 2.1*	Anketa e Punës së Fëmijëve në Shqipëri / INSTAT / ILO	2010	2.8

Figura 4: Të dhënat për punën dinjitoze sipas botimit të UNICEF dhe INSTAT "Treguesit e Mirëqënies së Fëmijeve dhe Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri 2016-19" f. 19

Lidhja e qëllimit të politikës me nën-kapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së.

Ky qëllim i politikës lidhet me Kapitullin V të MSA-së dhe titujt VII dhe VIII të saj respektivisht me nenet që kanë të bëjnë fuqizimin e institucioneve, bashkëpunimin social dhe kulturor, shoqërinë e informacionit dhe zhvillimin rajonal e lokal. Qëllimi i dytë i politikës së SKR 2022-2029 lidhet me kapitullin V dhe nenin 100 Arsimi, neni 109 kërkimi shkencor dhe neni103 shoqeria e informacionit. Po ashtu ai lidhet me nenet 110 dhe 111 që kanë të bëjnë me zhvillimin rajonal dhe administratën publike.

Ky qëllim gjithashtu lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023[21] përmes kapitujve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, kapitullin 10 për shoqërinë e informaciont dhe media, kapitullin 19 në lidhje me politikat sociale, kapitullin 24 që lidhet me drejtësinë dhe sigurinë, kapitullin 26 në lidhjen që ka me çështjet e kulturës dhe sporteve si edhe me kapitullin 28 në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit.

Tabela 9: Treguesit e rezultateve të lidhur me Qëllimin e Politikës 2

Lloji i treguesit	**Emërtimi i treguesit**	**Lidhja me Qëllimin e Politikës**	**Lidhja me Objektivin Specifik**	**Institucioni Përgjegjës**
Rezultati	Shkalla e papunësisë së të rinjve (%) të ndarë sipas gjinisë	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	MSHRF/ INSTAT/ AKPA/ MFE
Rezultati	Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës sipas gjinisë	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu	Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive.	MSHRF/ AKPA/ INSTAT/ MFE

Miratuar me Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 17.2.2021 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021–2023."

		mundësitë për të hyrë në tregun e punës.		
Rezultati	% e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	AKPA/MFE
Rezultati	Numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi/mobiliteti arsimore	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuari cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.	MAS, AKKSHI, AKPA
Rezultati	% e të rinjve që kanë filluar biznesin me mbështetjen financiare të shtetit.	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	MSHRF/ MFE

Objektivi Specifik 2.1:

Të rinjtë jane të aftësuar, të mirëinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomisht aktive.

Analiza e Situatës dhe Sfidat

SIPAS PKIE 2022 – 24 (fq. 74) shhkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15 – 29 vjeç, është në nivelet 53 - 54% duke pësuar rritje të lehta nga viti në vit. Edhe shkalla e papunësisë së të rinjve rrotullohet mes shifrave 20% - 21% dhe me ulje të lehta krahasuar në vitet e mëparshme. Shkak për këto ndryshime janë edhe politikat e ndërmarra për nxitjen e punësimit dhe zhvillimi i programeve që fokusohen te punësimi i të rinjve duke përfshirë elemente si:

- Punësim i subvencionuar për të rinjtë, gratë me fëmijë ne ngarkim, të rinjtë e pakicave, ata me aftësi të kufizuara si edhe ata që kthehen nga migrimi
- trajnimit nëpërmjet punës
- praktika profesionale
- pune publike ne komunitet
- vetëpunësim

Dinamika e tregut të punës po përmirësohet vazhdimisht duke reflektuar efektivitetin e politikave të ndërmarra nga qeveria që shkon në favor të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe nxitjes së punësimit. Në kuadër të analizave dhe studimeve të bëra për këtë strategji, u vu re nuk ka rritje të papunësisë mes të rinjve dhe shifrat e papunësisë janë stabilizuar. Nga ana tjetër numri i të rinjve që largohen nga vendi është në rritje sipas INSTAT[22] duke kërkuar politika shumë më aktive për nxitjen e punësimit mes të rinjve dhe zhvillimin e një kulture të bërjes së të ardhmes brenda vendit.

Zhvillimet e fundit që ka ndërmarrë qeveria në lidhje me nxitjen e inovacionit përmes startup-eve, digjitalizimit të shërbimeve dhe zhvillimin e lëndëve të kodimit tregojnë për seriozitetin e masave për t'u përballuar me këto fenomene dhe rëndësinë që i kushtohet punësimit të të rejave dhe të rinjve. Ky proces duhet të shkojë krah për krah me një proces reformimi të shërbimit të këshillimit për karrierë që i ofrohet ose nuk i ofrohet të rinjve në shkolla apo institucionet e formimit profesional. Mungon edhe veprimi në nivel vendor për të nxitur dhe zhvilluar punësimin rinor.

Bazuar në mendimet dhe idetë e të rinjve këto shërbime jo vetëm duhen modernizuar dhe digjitalizuar por në të njëjtën kohë duhet të përshtaten me kërkesat e të rinjve, t'i kuptojnë më mirë ata dhe nevojat e tyre, dhe t'i paraprijnë zhvillimeve të tregut të punës. Këto përmirësime së bashku me mbështetjen që kërkojnë të rinjtë për të rritur shkallën e tyre të lëvizshmërisë brenda vendit dhe në rajon do të sillnin ndryshime në mënyrën se si të rejat dhe të rinjtë marrin vendimet e tyre për të ardhmen dhe bërjen e vetes aktiv në tregun e punës.

SFIDA

[22] Sipas të dhënave zyrtare të Institutit Shtetëror të Statistikave, INSTAT, nga viti 2016 deri në fund të vitit 2021 nga Shqipëria kanë emigruar rreth 221 mijë e 48 persona me një mesatare vjetore prej 38 mijë e 841 persona. Vetëm vitin e kaluar nga Shqipëria emigruan 42 mijë e 48 persona, pjesa më e madhe të rinj të moshës 18 deri në 40 vjeç, duke ndikuar ndjeshëm në tkurrjen e fuqisë punëtore edhe në bujqësi. Për më shumë shiko: https://www.zeriamerikes.com/a/6633053.html

- Forcimin e mëtejshëm të mekanizmave për kërkimin dhe aksesin në punë, investimin në shërbime profesionale dhe zhvillimi i aftësive punëkërkuese brenda një mjedisi lejues dhe mundësues për zhvillimin e vetëpunësimit dhe të aftësive sipërmarrëse.

- Lehtësim të aksesit në kredi dhe mbështetje të shtuar qeveritare për krijimin e fondeve për start-up duke i kushtuar shumë rëndësi edhe promovimit të këtyre skemave në çdo bashki si popullatën rinore të bashkisë por edhe për ata që kthehen nga migrimi.

- Punë të zgjeruar për përhapjen e ndërmarrjeve sociale bazuar edhe në udhëzuest e hartuar në lidhje me këtë formë të biznesit social

- Krijimin e kushteve mbështetëse për gratë e reja me qëllim shpërndarjen më të drejtë të punëve në aspektin gjinor vazhdon të mbetet sfidë veçanërisht në tregun e punës.

- Gjurmimin e nxënësve dhe studentëve pasi përfundojnë studimet duhet të realizohet për të kuptuar lidhjet me tregun e punës, evidentuar APAA dhe për të kuptuar diferencën mes regjistrimeve dhe diplomimeve në arsim të lartë.

- Krijimin e alternativave të trajnimit dhe arsimit profesional si një mundësi alternative për arsimin dhe riaftësim.

Institucionet Drejtuese:

MSHRF, MEF, AKPA, AKR

Institucionet Pjesëmarrës:

MAS, MiSHMS

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuara janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me nën-kapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së.

Objektivi Specifik 2.1 synon nxitjen dhe rritjen e punësimit për të rinjtë si edhe zhvillimin dhe përmirësimin e programeve që kanë të bëjnë me këshillimin për karrierë. Për pasojë ky objektiv lidhet ngushtë me OZHQ-të 8 (punësimi dinjitoze) dhe OZHQ 4 (arsimi cilësor).

Objektivi lidhet me Kapitullin V të MSA, nenin 77, që lidhet me kushtet e punës mundësitë e barabarta si edhe me titullin VIII të MSA me nenin 100 të saj.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 10: Lista e treguesve kyç të performancës lidhur me objektivin specifik 2.1

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit	Lidhja me Qëllimin e Politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni Përgjegjës
Rezultati	Shkalla e pjesëmarrjes së të	Novacioni, edukimi, autonomia,	Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për	MSHRF/ AKPA/

	rinjve në tregun e punës sipas gjinisë	drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive.	INSTAT/ MFE

Lista e plotë e masave në planin e veprimit.

Tabela 11: Lista e masave për arritjen e Objektivit specifik 2.1

Nr	***Masat sipas objektivitit specifik 2.1:***
2.1.1	Bashkërendohet Politika Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë duke rritur nivelin e punësimit dhe sipërmarrjen e të rinjve përmes angazhimit dhe ndërveprimit të këshillave vendorë rinorë, ndërmarrjeve dhe startup-eve.
2.1.2	Nxitet dhe forcohet punësimi rinor në fushën e TIK dhe digjitalizimit përmes zhvillimit të programeve të aftësimit në kodim, TIK dhe digjitalizim bazuar në studimet e tregut dhe zhvillimit të punësimit në këtë fushë si në Shqipëri dhe me gjerë.
2.1.3	Pranë institucioneve arsimore dhe aftësuese zhvillohen shërbime inovative dhe digjitale të këshillimit për punësim dhe orientim në karrierë, miqësore për të rejat dhe rinjtë, dhe në respektim të shanseve të drejta dhe të barabarta për të arritur potencialin e plotë rinor.
2.1.4	Nxitet dhe forcohet novacioni përmes sipërmarrjeve rinore dhe nga të rinjtë duke e vënë novacionin rinor në fokus të kuadrit ligjor dhe politikave publike të Start Up-eve, politikave të punësimit dhe mbështetjes së nismave si *hapësirat e përbashkëta për punë (*co-working spaces).
2.1.5	Përmirësohen programet dhe shërbimet që ofrojnë mbështetje për lëvizshmërinë e të rinjve, dhe bashkëpunimin mes tyre brenda vendit e më gjerë.
2.1.6	Lehtësohet **transporti publik ndër-qytetas për të rinjtë**, duke rritur lëvizshmërinë e tyre në qarqe.

Objektivi Specifik 2.2:

Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuari cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Konceptet për punësimin në Shqipëri lidhen ngushtë me degën e studimit që një e re apo i ri merr në universitet dhe me shanset për t'u punësuar në administratë publike apo "shtet" duke kërkuar kështu një hyrje të sigurtë në tregun e punës. Edhe pse këto lloj konceptesh po sfidohen nga rritja e numrit të të rinjve sipërmarrës dhe të angazhuar në nisma start-up mbetet dhe nga numri në rritje i të rinjve në arsimin profesional në Shqipëri karriera vazhdon të jetë e lidhur ngushtë me mbarimin e studimeve të larta dhe gjetjen e një pune të sigurtë.

Shumë të rinj e shohin si problem e jo si mundësi të re faktin qe ata punësohen në një fushë qe nuk lidhet drejtpërsedrejti me studimet e tyre universitare. Kultura e gjetjes se vendit të punës bazuar në njohuritë e marra në menyrë informale dhe joformale nuk ka fituar terrenin e duhur edhe pse tashmë janë miratuar vendimet qeveritare që e mundësojnë njohjen e përvojave të tilla, të cilat i shërbejnë të rinjve për t'u punësuar jashtë fushës së tyre të studimeve.

Zhvillimi i sektorit të ndërmjetësimit profesional apo shërbimit të karrierës si përmes zyrave të punës dhe në sistemin arsimor është një tjetër sfidë që kërkon zgjidhje të menjëhershme duke plotësuar edhe kërkesën më kryesore të të rinjve në takimet konsultuese në cdo nivel.

Së fundi sigurimi dhe nxitja e punësimit në vend dhe angazhimi i të rinjve në punësim të qëndrueshëm kërkon politika edhe më të forta nga ana e qeverisë për t'u përballuar efektivisht me fenomenin e largimit të rinisë nga vendi. Kjo strategji synon në këtë pjesë të ndryshojë perceptimet për punësimin në vend.

Mbetet shumë për të bërë për të kuptuar dhe studiuar më thellë zhvillimet në arsimin profesional dhe lidhjet që disa nga institucionet kanë krijuar me tregun e punës. Kuptimi më i mirë i të dhënave të zbërthyera në nivel qarku apo bashkie do të siguronte një shpërndarje më të mirë të degëve të studimit duke i orientuar ato fuqishëm nga tregu i punës e duke zhvilluar programe studimi që lidhen me digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve.

Zbërthimi i të dhënave statistikore do mundësonte edhe të kutpuarin e të rinjve në aktivitetet jashtë shkollore dhe jetën e tyre virtuale duke hapur kështu mundësitë për të bërë realitet planet për digjitalizimin e proceseve arsimore. Sfida në këtë proces mbetet sigurimi i furnizimit me shërbime të qëndrueshme dhe të sigurta interneti në shkolla dhe mjedise të tjera rinore.

Institucionet Drejtues

MSHRF, MAS, AKR

Institucionet Pjesëmarrës

MEF, AKPA, AKSHI, RASH, AKCESK

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuara janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me nën-kapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së.

Objektivi Specifik 2.2 synon të fuqizojë informacionet që marrin të rinjtë në lidhje me tregun e punës dhe zgjedhjes më të mirë të përvojës së tyre arsimore që t'i shërbejë punësimit.

Ky objektiv lidhet me Kapitullin V të MSA, nenin 77, që specifikon kushtet e punës mundësitë e barabarta si edhe me titullin VIII të MSA me nenin 100 të saj për arsimin dhe trajnim cilësor.

Ky qëllim gjithashtu lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023[23], me kapitullin 2 për lëvizjen e lirë të punëtorëve, kapitullin 19 për politikat sociale të punësimit dhe kapitullin 26 për arsimin dhe kulturën.

Ky objektiv specifik lidhet me OZHQ 8 (punësimi dinjitoze) dhe OZHQ 4 (arsimi cilësor) por edhe me OZHQ 10 (zvogëlimi i pabarazive) dhe 17 (partneritet per qëllimet).

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 12: Lista e treguesve kyç të performancës lidhur me objektivin specifik 2.2

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit	Lidhja me Qëllimin e Politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni Përgjegjës
Rezultati	Numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi/mobiliteti arsimore	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuari cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.	MAS, AKKSHI, AKPA

Lista e plotë e masave në planin e veprimit:

Tabela 13: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.2

Nr. i masës	*Masat sipas objektivit specifik 2.2*
2.2.1	Mbështeten të rejat dhe të rinjtë në pikat kritike të zhvillimit si kalimi në shkollën e mesme të lartë dhe kalimi nga shkolla në tregun e punës ose në studimet e nivelit universitar me këshillim dhe informacione që lidhin përzgjedhjen e fushës së

Miratuar me Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 17.2.2021 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021–2023."

	arsimimit me mundësitë në tregun e punës në bashkërendim me masat e parashikuara në në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021 – 26.
2.2.2	Promovohet përdorimi i sigurt i teknologjive të reja dhe mbështetet përvetësimi i aftësive dhe kompetencave digjitale të shekullit të 21-të për të rinjtë si në sistemin arsimor të përgjithshëm dhe atë profesional ashtu edhe në sistemin e trajnimeve formale dhe jo-formale.
2.2.3	Mbështeten dhe zhvillohen programe të seksioneve sportive amatore, arteve, artizanatit dhe aktiviteteve të tjera jashtë-kurrikulare që synojnë zhvillimin e aftësive për jetë të shëndetshme, me fokus të veçantë tek të rejat.

Objektivi Specifik 2.3:

Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemit arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Mbetet fakt që shumica e të rinjve gjejnë punësim në sektorin e shërbimeve dhe fasonerisë ku nuk kërkohet ndonjë nivel i lartë i njohurive të specializuara. Sfida në fushën e punësimit është rritja e punësimit të qëndrueshëm, afatgjatë dhe me standarte apo sic i referohet OKB në OZHQ 8 si "punësim i denjë".

Sfidë tjetër thelbësore është rritja e zbatueshmërisë, kryesisht jashtë Tiranës, i legjislacionit të miratuar për nxitjen e punësimit sipas programeve dhe vendimeve të qeverisë dhe në përputhje me Strategjinë e Punësimit dhe Aftësive e cila është në proces rinovimi. Në takimet me të rejat dhe të rinjtë në kuadër të kësaj strategjie u vu re jo vetëm mungesa e informacionit për këto programe por edhe mosnjohja e programeve të financimit dhe praktikave të punësimit. Rritja e transparencës në vendim-marrje dhe rritja e pjesëmarrjës së të rejave dhe të rinjve do të rrisnin efektshmërinë e këtyre programeve.

Në kuadër të programeve si Garancia Rinore që do të mbështetet nga BE duhet gjetur rruge e mundësi për të sfiduar burokracinë duke i zvogëluar hapat që një e re ose i ri duhet të ndërmarrë për të fituar nga këto programe, duke i bërë shërbimet për rininë më të orientuara e më miqësore kundrejt tyre.

- Zbutja e papunësisë mes të rinjve duke qenë se papunësia është një nga shkaqet kryesore për përjashtimin social
- Rritjen e nivelit arsimor për të ulur papunësisë dhe diskriminim për shkak të mungesës së arsimit.

Institucionet Drejtuese:

MSHR, MEF, MAS

Institucionet Pjesëmarrës:

MiSHMS, AKR, AKPA, AKAPFK,

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuara janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me nën-kapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së dhe OZHQ-të.

Objektivi Specifik 2.2 synon të fuqizojë integrimin e të rejave dhe të rinjve në shoqëri duke rritur autonominë e tyre përmes punësimit dhe kalimit të suksesshëm nga shkolla në punësim.

Ky objektiv lidhet me Kapitullin V të MSA, nenin 77, që specifikon kushtet e punës mundësitë e barabarta si edhe me titullin VIII të MSA me nenin 100 të saj për arsimin dhe trajnim cilësor.

Ky qëllim gjithashtu lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023[24], me kapitullin 2 për lëvizjen e lirë të punëtorëve, kapitullin 19 për politikat sociale të punësimit dhe kapitullin 26 për arsimin dhe kulturën.

Ky objektiv specifik lidhet me OZHQ 8 (punësimi dinjitoze) dhe OZHQ 4 (arsimi cilësor) por edhe me OZHQ 10 (zvogëlimi i pabarazive) dhe 17 (partneritet per qëllimet).

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 14:Treguesit Kyç të Përformancës të lidhur me Objektivin Specifik 2.3

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit	Lidhja me Qëllimin e Politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni Përgjegjës
Rezultati	Shkalla e papunësisë së të rinjve (%) të ndarë sipas gjinisë	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	MSHRF/ INSTAT/ AKPA/ MFE
Rezultati	% e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt	AKPA/ MFE

Miratuar me Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 17.2.2021 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021–2023."

		kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	tregut të punës dhe moshës madhore.	
Rezultati	% e të rinjve që kanë filluar biznesin me mbështetjen financiare të shtetit.	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	MSHR F/ MFE

Lista e plotë e masave në planin e veprimit.

Tabela 15:Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.3

Nr i masës	***Masat sipas objektivit specifik 2.3***
2.3.1	Nxiten punët e denja dhe të përshtatshme për të rejat dhe të rinjtë përmes politikave të punësimit, miqësore dhe të orientuara nga të rinjtë, që kontribuojnë në krijimin e vendeve të punës për të rejat dhe të dhe që sigurojnë qasje novative dhe digjitale në informacionet mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e punësimit.
2.3.2	Sigurohet mbështetje e përshtatshme dhe miqësore për të rinjtë dhe të rejat e në veçanti për ata me aftësi të kufizuara mbi punësueshmërinë e tyre, punësimin dhe sipërmarrjen rinore.
2.3.3	Nxitet dhe promovohet novacioni në tregun e punës për punësimin me kohë të pjesëshme të orientuar kryesisht nga të rejat.
2.3.4	Fuqizohen qasjet e integruara për të mbështetur të rinjtë që rrezikojnë lënien e parakohshme të shkollimit dhe pa mbështetje për shkollim në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit

Qëllimi i Politikës 3:

Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)

Qëllimi synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

- **Objektivi Specifik 3.1:** Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale
- **Objektivi Specifik 3.2:** Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore, sociale, fizike dhe seksuale.
- **Objektivi Specifik 3.3:** Të rejat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri duke pasur mundësi për strehim dhe argëtim (në kulturë, art dhe sport)

Institucionet përgjegjëse drejtuese janë MSHRF, AKR, dhe MSHMS

Ndërkohë institucionet kryesore pjesëmarrëse janë AKSHI, AKCESK, AMA, Agjencia e Mbrojtjes së Të Drejtave të Fëmijëve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Bashkitë, ISHP, AMMV, MB, MD, MIE dhe ASCAP

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuara janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Standardeve të tjera.

Qëllimi i Politikës 3 lidhet me OZHQ 16 në kuadrin e forcimit të institucioneve të drejtësisë dhe mbështetjes së te drejtave të njeriut, OZHQ 3 në kuadrin e mbështetjes së të rinjve dhe të rejave për mirëqenie dhe shëndet të mirë, OZHQ 5 në kuadër të mbështetjes me masa për përfshirjen sociale, OZHQ 11 në kuadër të mbështetjes që i bën programeve qeveritare për strehimin e çifteve të reja në banesat e tyre dhe OZHQ 10 me synimin për zvogëlimin e pabarazive dhe mbështetjes të aktiviteve që minimizojnë mënjanimin social.

Ky qëllim i politikës lidhet me Kapitullin V të MSA-së dhe titujt VII dhe VIII të saj respektivisht me nenet që kanë të bëjnë fuqizimin e institucioneve, bashkëpunimin social dhe kulturor, shoqërinë e informacionit dhe zhvillimin rajonal e lokal. Ky qëllim gjithashtu lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023[25] përmes kapitujve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, kapitullin 10 për shoqërinë e informaciont dhe media, kapitullin 19 në lidhje me politikat sociale, kapitullin 24 që lidhet me drejtësinë dhe sigurinë, kapitullin 26 në lidhjen që ka me çështjet e kulturës dhe sporteve si edhe me kapitullin 28 në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit.

Miratuar me Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 17.2.2021 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021–2023."

Tabela 16: Lista e treguesve kyç të performancës të lidhur me qëlimin 3

Nr	Lloji i treguesit	Emri i Treguesit	Lidhja me Qëllimin e Politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni Përgjegjës
1	Rezultati	% e të rinjve që raportojnë se praktikojnë stile jetese të shëndetshme	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHRF/ MSHMS/ AKR
2	Rezultati	% e qendrave shëndetësore të pajisura me mjedise miqësore për rininë	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHRF/ MSHMS
3	Rezultati	% e nëpunësve publikë të trajnuar mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHMS/ ASPA

Objektivi Specifik 3.1:

Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale.

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Veçanërisht në situatat e krijuara nga tërmetet e vitit 2019 dhe pandemia Covid-19, aspektet e përfshirjes më të madhe rinore dolën më në pah në politikat e ndërmarra nga qeveria. Duke qenë se Shqipëria është pjese e zhvillimeve globale dhe lëvizjet migratore kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi jetën e të rinjve dhe migrimin e tyre, angazhimi në veprimtari sociale që zhvillojnë komunitetin dhe përmirësojnë kushtet e të rinjve mbetet parësor në çdo qeveri e në politikat zhvillimore që ndërmerr vendi.

Qeveria i ka kushtuar shumë rëndësi çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe parandalimit të krimeve nga të miturit duke zhvilluar programe specifike në këto fusha të cilat edhe shpjegojnë uljen e numrit të të rinjve të dyshuar për vepra penale apo në institucionet e privimit të lirisë sipas tabelave në vijim.

Norma e fëmijëve (nën 18 vjeç) të dyshuar për vepra penale për 100,000 fëmijë, sipas grupmoshës



Shpjegimi: Numri i fëmijëve (nën 18 vjeç) të dyshuar për kryerjen e veprave penale, të regjistruar në polici gjatë vitit, në raport me 100,000 popullatë mesatare përkatëse
Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / INSTAT

Norma e fëmijëve 14-17 vjeç në institucionet e privimit të lirisë për 100,000 popullatë përkatëse



Shpjegimi: Numri i fëmijëve 14-17 vjeç në paraburgim dhe të dënuar me burgim në raport me 100,000 popullatë mesatare përkatëse, në fund të vitit
Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve / INSTAT

Mbetet gjithsesi shumë për të bërë në lidhje me format e krimit kibernetit dhe të bullizimit të të rinjve në formë kibernetike. Po ashtu, nga raporti i vlerësimit të PKVR 2015-2020, gjashtë indikatorë (60%) kanë mbetur të parealizuar në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtejn sociale

të të rinjve duke përfshirë edhe çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e informacioneve mbi dhunën, pabarazinë sociale, dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

- Mungesa e mjediseve të përshtatshme dhe të sigurta për lojën dhe aktivitetet fizike ne komunitet.
- Numër i mjaftueshëm psikologësh dhe punonjësish socialë të specializuar në punën me të rinjtë nëpër institucionet arsimore të arsimit të mesëm të cilët bashkëpunojnë me shërbimet sociale të bashkive dhe drejtoritë arsimore.

Institucionet Drejtuese

-MSHRF, AKR, MAS, MD dhe MB

Institucionet Pjesëmarrëse
-AKSHI, AKCESK, AMA, Agjencia e Mbrojtjes së Të Drejtave të Fëmijëve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Bashkitë

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuara janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me nën-kapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së dhe OZHQ-të.

Objektivi Specifik 3.1 synon rritjen e sigurisë së të rejave dhe të rinjve duke krijuar mundësi për përfshirje dhe evituar mënjanimin social. Ky objektiv lidhet me Titullin VII të MSA-së dhe nenin 78 të saj që ka të bëjë me forcimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës *si dhe* Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023 në pjesën e kriterit politik e më specifikisht respektimin e të drejtave të njeriut po edhe me çështjen e zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Në drejtim të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, ky objektiv specifik lidhet me OZHQ 16 në aspektin e promovimit të drejtësisë dhe institucioneve të forta, me OZHQ 3 në lidhje me mirëqenien dhe OZHQ 5 në aspektin e barazisë gjinore.

Tabela 17: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 3.1

Nr. i masës	***Masat sipas objektivit specific 3.1:***
3.1.1	Bashkërendohet zbatimi i Strategjive dhe programeve Kombëtare të Mbrojtjes dhe Sigurisë me një fokus të veçantë tek prezenca virtuale e të rinjve online, krijimi i hapësirave të sigurta, krimi kibernetik dhe bullizmi online (digjital)
3.1.2	Fuqizohen programet që trajtojnë çështjet e rreziqet e sigurisë me të cilat përballen të rejat dhe të rinjtë e trafikuar, rreziqet e formave të ndryshme të krimit dhe, parandalimi dhe luftimi i dhunës seksuale me bazë gjinore dhe dhunës nga partneri ndaj grave të reja dhe parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore/të rinjve.
3.1.3	Fuqizohen programet që u mundësojnë të rinjve të përfshirë në grupe të dhunshme ose të radikalizuara të braktisin dhunën duke propozuar të ashtuquajturat "strategjitë e daljes".

3.1.4	Promovohen programet për të rinjtë në masa reformuese duke vendosur mekanizma ri-integrimi dhe mbështetje për trajnimin e aftësive për punësim, integrimin përmes punës në komunitet dhe mbështetje psikologjike dhe sipërmarrjeve sociale.
3.1.5	Përmirësohen me qasje specifike rinore, miqësore dhe të pranueshme, programet që trajtojnë migrimin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore me në fokus parandalimin e këtyre fenomeneve dhe kthimin e të rinjve në shkollë, trajnim ose punë.
3.1.6	Fuqizohen programet rinore që fokusohen në të drejtat e njeriut dhe të pakicave, barazinë gjinore, pranimit të diversitetit, tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm.
3.1.7	Fuqizohen programet dhe aktivitetet rinore që trajtojnë çështje në lidhje me format e ndryshme të diskriminimit kundrejt identiteteve socio-kulturore, fetare, seksuale dhe të tjera.

Objektivi Specifik 3.2:

Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore, sociale, fizike, dhe seksuale.

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19 dhe vështirësitë që shoqëruan procesin e kapërcimit të krizës së tërmeteve të vitit 2019 kanë lënë pasoja shëndetësore edhe mes të rinjve shqiptarë. Duket se dhënia e shërbimeve për të rinjtë (adoleshentët) dhe shërbimet miqësore e të orientuara nga të rinjtë janë ndërprerë që prej vitit 2015 në Shqipëri[26] edhe pse strategjia e promovimit të shëndetit publik, shëndetit seksual dhe riprodhues dhe paketa bazë e shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor (versioni i rishikuar) synojnë nevojat e të rinjve dhe adoleshentëve. Dokumentet janë në përputhje me planin e veprimit mbi sigurinë kontraceptive për 2017-2022.

Strategjia e promovimit shëndetësor të vendit synon adoleshentët dhe të rinjtë duke rritur ndërgjegjësimin shëndetësor dhe duke krijuar mjedise mbështetëse për mënyra më të shëndetshme jetese, duke trajtuar çështje që përfshin ushqimin, veprimtarinë fizike, dhunën, pirjen e duhanit, alkoolin, drogën, shëndetin mendor, shëndetin seksual dhe riprodhues dhe planifikimin familjar. Ajo përfshin gjithashtu një objektiv që "së paku 50% e të rinjve përdorin shërbime shëndetësore miqësore për të rinjtë". Paketa bazë e shërbimeve përfshin ofrimin e informacionit mbi shëndetin seksual dhe riprodhues, planifikimin familjar dhe STI-të për të rinjtë.

Në vitin 2015 UNFPA ndihmoi Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të vendosur standardet për shërbimet shëndetësore miqësore ndaj të rinjve, të cilat u miratuan por nuk u zbatuan pasi u mor vendimi për integrimin e shërbimeve miqësore për të rinjtë në paketën Bazë të shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor (versioni i rishikuar), i cili deklaroi se të gjithë mjekët e familjes pritej të shihnin të rinjtë. Standardet ndërkombëtare të ofrimit të shërbimeve për të rinjtë kanë kërkesa specifike për të siguruar privatësinë përmes mjediseve të veçanta dhe hyrjes së veçantë në një strukturë klinike mjekësore për të ofruar shërbime miqësore për të rinjtë. Kjo gje mbetet një shqetësim i veçantë në zonat rurale, ku aftësia për të ruajtur konfidencialitetin është e kufizuar.

Shëndeti mendor i të rinjve rrezikohet nga neglizhenca kundrejt problemeve të kësaj natyre por edhe nga lehtësia për të hyrë në rrjetet sociale ku të rinjtë ndeshen me elemente dëmtuese për shëndetin e tyre si varësia nga krahasimi me figura të njohura, qasja në materiale që janë të papërshtatshme për të rinjë, mungesa e kohës për tu kujdesur për vete, ngacmimet kibernetike dhe diskriminimet.

[26] Assessment of sexual, reproductive, maternal, newborn, child and adolescent health in the context of universal health coverage in Albania, p 22.
https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/330457/9789289054706-eng.pdf

Studime të ndryshme[27] tregojnë se gati një në tre fëmijë (32%) janë lënduar ndonjëherë fizikisht nga prindërit ose të rriturit e tjerë në familjet e tyre përkatëse. Prevalenca e abuzimit emocional gjatë gjithë jetës ishte 16% (13% tek djemtë kundrejt 18% tek vajzat). Abuzimi seksual qëndron në nivelin 8% dhe prevalenca e marrëdhënieve seksuale gjatë gjithë jetës me një të rritur (e tentuar dhe / ose e përjetuar) është rreth 3%. Korrelacione të rëndësishme të abuzimit seksual gjatë gjithë jetës ishin papunësia e nënës, përdorimi i duhanit dhe alkoolit gjatë gjithë jetës, marrëdhëniet seksuale gjatë gjithë jetës, si dhe dhuna në familje.

3.8.1	Mbulimi i popullsisë me shërbime bazike shëndetësore (%)	I pamatur
3.9.1	Vdekshmëria në 100,000 popullatë, për shkak të ajrit të ndotur të ambientit ose të shtëpisë	I pamatur
3.a.1 (1)	Prelevanca e të rinjve (15-19, 20-24 vjeç) që konsumojnë produkte të ndryshme të duhanit	I pamatur

Figura 5: Sipas botimit të INSTAT dhe UNICEF "Treguesit e Mirëqenies së Fëmijeve. Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri 2016-19" f.18

Strategjia e Shëndetit 2021 – 2030 ka reflektuar nga mësimet e nxjerra në menaxhimin e pandemisë COVID-19 dhe adreson në mënyrë specifike nevojën për të rritur kapacitetet për t'iu përgjigjur emergjencave shëndetësore dhe për të rritur elasticitetin e sistemit shëndetësor në përgjithësi. Ajo synon të vazhdojë përpjekjet për përmirësimin e shëndetit, mirëqenien e popullatës duke përmbushur të drejtat e tyre për shëndet të mirë gjatë viteve 2021-2030. Strategjia është formuluar mbi pesë synime themelore, investimi në shëndetin e popullatës përgjatë gjithë jetës, mbulimit me shërbim universal, fuqizimin e sistemit shëndetësor, pikërisht me në qendër qytetarin, përforcimi i përgjigjes dhe shërbimeve të emergjencës dhe shëndetit digjital.

Sfida:

- Rifreskimi dhe zbatimi i protokolleve për shërbime shëndetësore miqësore kundrejt te rinjve
- Përballimi vetjak me problemet dhe pa mbështetje nga shkolla dhe sistemi shëndetësor.
- Mungesa e politikave për të promovuar shëndetin dhe mirëqenien e adoleshenteve dhe të rinjve.
- Ofrimi i shërbimeve miqësore për të rinjtë falas/pa pagese në 12 qarqet e vendit si edhe riorientimi i shërbimeve ekzistuese të kujdesit shëndetësor parësor për të qenë miqësore ndaj të rinjve, përfshirë shërbimet e shëndetit riprodhues.
- Edukimi i adoleshentëve me aftësitë për jetën, duke përshirë edhe informacionet për shëndetin, specifike sipas gjinisë dhe me ndjeshmëritë e duhura kulturore.
- Mungesa e shërbimeve të integruara shëndetësore për të menaxhuar adoleshentët abuzues me substancat, (duhani, alkoli, drogat) dhe varësitë (përfshi edhe ato nga lojrat digjitale dhe pajisjet elektronike.

[27] Studimi "Sjelljet Shëndetësore të fëmijëve të moshës shkollore 11, 13 dhe 15 vjeç, 2017/18

- Diskrimini apo rreziku nga diskriminimi që përjetojnë grupe të rinjsh në shoqëri në bazë të gjinisë, moshës, orientimit seksual dhe etnisë
- Bërjen e drejtësisë sociale bazuar në ndarjet rurale dhe urbane

Institucionet Drejtuese

MSHRF dhe MSHMS

Institucionet Pjesëmarrëse
AKR, ISHP

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuara janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me nën-kapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së.

Objektivi Specifik 3.2 synon të rrisë praktikën e shëndetit të mirë dhe ushtrimin e sporteve përmes fuqizimit të punës rinore në këshillimin shëndetësor dhe bashkëpunimit të fortë me MSHMS në aspektet e provomimit të aktiviteteve në lidhje me strategjitë kombëtare të shëndetit dhe përfshirjes.

Objektivi është i lidhur me nenin 78 të Titullit të VII të MSA-së si edhe me nenin 99 të Titullit VIII.

Ky objektiv specifik lidhet me OZHQ 3 që synon shëndetin e mirë dhe mirëqenien.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 18:Lista e treguesve kyç të performancës lidhur me objektivin specifik 3.2

Lista e plotë e masave është dhënë në planin e veprimit IPSIS

Tabela 19: Lista e masave për arrtjen e objektivit specifik 3.2

Nr i masës	***Masat sipas objektivit specific 3.2***
3.2.1	Bashkërendohet Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2021-2030, Agjenda e Fëmijve 2021 – 2026, planet e veprimit dhe strategjitë e tjera lidhur me to me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, në veçanti promovimin e jetesës së shëndetshme.
3.2.2	Zhvillohen qasje të pranueshme dhe miqësore për të rinjtë në strukturat shëndetësore, të cilat marrin në konsideratë tranzicionin nga strukturat dhe shërbimet mjekësore për fëmijë te ato për të rriturit (nevoja për të zhvilluar standarde miqësore për të rinjtë).
3.2.3	Zhvillohen shërbime të reja dhe forcohen ato ekzistuese nëpër shkolla me cilësi të garantuar për ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik, si edhe mbështeten shërbimet online të shëndetit mendor në platformën për rininë "Të rinjtë për të rinjtë".

Nr	Lloji i treguesit	Emri i Treguesit	Lidhja me Qëllimin e Politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni Përgjegjës
1	Rezultati	% e të rinjve që raportojnë se praktikojnë stile jetese të shëndetshme	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHRF/ MSHMS/ AKR
2	Rezultati	% e qendrave shëndetësore të pajisura me mjedise miqësore për rininë	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHRF/ MSHMS
3	Rezultati	% e nëpunësve publikë të trajnuar mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHMS/ ASPA

3.2.4	Sigurohet pranimi i të rinjve në shërbimet e duhura të parandalimit dhe promovimit sipas Planit Kombëtar të Veprimit mbi Shëndetin dhe të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese 2022 - 2030 për të siguruar që të rinjtë që jetojnë në Shqipëri marrin edukim / informacione të përgjithshme në formë të pranueshme dhe miqësore ndaj tyre.
3.2.5	Propozohen dhe zhvillohen veprimtari në lidhje me sjelljen e rrezikshme dhe konsumin e drogës duke siguruar që të rinjtë marrin informacione dhe edukim tërësor. Sigurohet që të rinjtë kanë akses në ndërhyrjet e duhura parandaluese dhe shërbimet e trajtimit të varësisë.

Objektivi Specifik 3.3:

Të rejat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri duke pasur mundësi për strehim dhe argëtim (në kulturë, art dhe sport)

Analiza e Situatës dhe Sfidat

Ligji për Rininë i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të hapësirave rinore të dedikuara për rininë dhe aktualisht qeveria po e mbështet këtë proces. Për më tej në programin qeveritar parashikohet mbështetja financiare për blerjen e apartamenteve nga çiftet e reja e cila lidhet edhe me politikën qeveritare të kalimit nga rindërtim pas tërmetit të vitit 2019 në ndërtime të reja banesash për çiftet e reja dhe ata që kërkojnë jetën e pavarur sepse ka një numër të madh të rinjsh që zgjedhin migrimin në vend të zhvillimit të tyre në vend për shkak të mungesës së banesës e kushteve të tjera.

OZHQ 10 - ZVOGËLIMI I PABARAZIVE		BURIMI	VITI	TË DHËNAT
10.2.1	Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) që jetojnë nën 50% e medianes së të ardhurave disponibël të ekuivalentuara	Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jeteses / INSTAT	2018	22.1

Figura 6: Studimi i INSTAT dhe UNICEF "Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri 2016-19" f. 20

Masat dhe aktivitetet e parashikuara në PKVR 2015-20 në lidhje me shëndetin, sportin dhe mjedisin ishin realizuar plotësisht në masën 48% ndërsa masat në lidhje me kulturën dhe vullnetarizmin në nivelin 39%. Ky nivel, edhe pse ndër më të lartit në lidhje me përmbushjen e indikatorëve lejon hapësira për zhvillime të reja dhe fokus më të madh në proceset e zhvillimit dhe të edukimit jashtë-shkollor ku programe si ai i shkollave komunitare dhe programi kombëtar për arte dhe zeje luajnë një rol kryesor për të integruar shoqërinë veçanërisht në një situatë post-pandemike.

Përfshirja dhe integrimi i të rejave dhe të rinjve dhe ulja e parabazive si ekonomike dhe gjinore paraqesin këto sfida:

- Zhvillimi i hapësirave rinore me standarte të përcaktuara dhe në përputhje me kërkesat dhe nevojat e të rinjve
- Ndërtimi i hapësirave në çdo bashki
- Krijimi i hapësirave të dedikuara për rininë në mjediset shkollore
- Ofrimi i shërbimeve dhe mbështjes së dedikuar për përfshirjen në shkolla
- Fuqizimi i shërbimeve rinore për të lehtësuar integrimin e të rinjve dhe kalimin e tyre në jetesë të pavarur

Institucionet Drejtuese

-MSHRF, MSHMS dhe MIE

Institucionet Pjesëmarrëse
-AKR, AMMV, Bashkitë, MAS, MSHMS, MB, MD, ASCAP

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuara janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me nën-kapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së.

Objektivi Specifik 3.3 është integrues nga natyra dhe synon si mos-përjashtimin e asnjë të reja apo të riu dhe angazhimin e tyre aktiv në shoqëri si përmes aktiviteve vullnetare ashtu edhe përmes zhvillimit të masave për më shumë aktivitete argëtuese rinore. Ky objektiv lidhet po asthu edhe me integrimin e të rinjve nga pikëpamja e strehimit dhe ndihmës për krijimin e jetës së pavarur në familjle të reja. Kështu ky objektiv lidhet me nenin 99 të Titullit VIII të MSA-s si edhe me nenin 101 që ka në qendër bashkëpunimin kulturor.

Ky objektiv specifik lidhet specifikisht me OZHQ 3 në aspektin e mbështetjes së shërbimeve dhe infrastrukturës rinore; me OZHQ 5 dhe 10 në aspektin e gjithëpërfshirjes dhe mos-përjashtimit socila si edhe me OZHQ 11 me fokusin që ka te sigurimi i strehimit të përballueshëm për të rinjtë dhe të rejat që mëvetësohen e duan të krijojnë familjet e tyre në banesa të vetat.

- Lista e plotë e masave është dhënë në planin e veprimit IPSIS.

Tabela 20: Masat sipas objektivit specifik 3.3

Nr i masës	***Masat sipas objektivit specific 3.3***
3.3.1	Mbështetet ndërtimi, riparimi dhe rinovimi i hapësirave publike të projektuara për të rinjtë me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta takimi edhe në kohën e lirë.
3.3.2	Bashkërendohet zbatimi i Strategjive dhe programeve Kombëtare të Gjithëpërfshirjes dhe monitorimi i zbatimit të politikave të përfshirjes, sigurisë dhe mbrojtjes me fokus të veçantë tek të rejat dhe të rinjtë.
3.3.3	Mbështetet dhe promovohet programi i qeverisë në lidhje me mbështetjen financiare të strehimit për familjet e reja dhe në bashkëpunim me aktorë qeveritarë qendrorë e vendorë si edhe organizatat donatore nxitet zhvillimi i programeve të tjera në mbështetje të familjeve dhe çifteve të reja.

Pjesa III: Masat prioritare të Qeverisë për zbatimin e dokumentit strategjik

1. Metodologjia e përcaktimit të masave prioritare

Për përcaktimin e masave prioritare në këtë strategji janë përdorur mekanizma që kanë lidhje me të rinjtë dhe nevojat e tyre prioritare.

Pjesa IV: Zbatimi, Llogaridhënia dhe Koordinimi

Zbatimi efektiv dhe i suksesshëm i SKR 2022-2029 do të arrihet përmes një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të verifikuar progresin në plotësimin ose jo të objektivave specifike dhe masave të vendosura në Planin e Veprimit.

I gjithë procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të menaxhohet përmes Komitetit Drejtues Sektorial për Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022 - 29, siç parashikohet në Urdhërin e Kryeministrit Nr,157 datë 22.10.2018 "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, dhe krijimin dhe funksionimin e një mekanizmi të integruar sektorial/ndërsektorial".

Komiteti Drejtues për Strategjinë e Rinisë do të operojë përmes grupeve tematike të cilat do të jenë pjesë e Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave për sektorin e rinisë dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse, si dhe nëpërmjet Sekretariatit Teknik i cili do të formalizohetme urdhër të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Raportet e monitorimit do të hartohen në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira si dhe do të diskutohen në grupet tematike të krijuara për këtë qëllim sipas objektivave specifike të SKR 2022-2029 dhe më pas miratohen në Komitetin Drejtues Sektorial për sektorin e rinisë.

Gjithashtu, është dakordësuar që të ngrihet një grup pune midis menaxhimit të nivelit të mesëm nga MSHRF dhe institucionet e qeverisjes së rinisë, si edhe MSHRF për të diskutuar problematikat dhe pengesat që dalin gjatë zbatimit të SKR dhe gjatë ushtrimit normal të aktiviteteve të institucioneve përkatëse, të cilat kërkojnë një qasje të përbashkët.

Në Qëllimin e Politikës 1 përfshihet përgatitja e statistikave të përmirësuara të sektorit dhe i sistemeve të përmirësuar të menaxhimit të performancës, me qëllim realizimin në kohë dhe cilësi të raportimit për plotësimin e objektivave.

• Metodologjia e monitorimit

MSHRF do të hartojë raporte gjashtë mujore dhe vjetore monitorimi dhe vlerësimi bazuar në standardet IPSIS për monitorimin dhe raportimin e dokumentave strategjike, të cilët do të prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikë-bërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në Planin e Veprimit të SKR për 2 vitet e ardhshme. Gjithashtu, do parashikohet dhe një monitorim afatmesëm për zbatimin në fund të vitit 2026. Plani i veprimit të dokumentit strategjik, duke marrë në konsideratë shkallën e mobilizimit të burimeve financiare për zbatimin e tij, do të rishikohet çdo 2-3 vjet për të siguruar në këtë mënyrë një vlerësim real për zbatimin e tij.

MSHRF do të përdorë metodologjinë e monitorimit të bazuar në standardet IPSIS që do të përcaktojnë se si do të kryhet procesi i monitorimit dhe vlerësimit me qëllim krijimin e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit të të dhënave të të gjithë institucioneve të përfshira në zbatimin e sistemit IPSIS.

Sipas këtij dokumenti strategjik, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të secilit objektiv dhe masë, mbi buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi. Për monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, në lidhje me zbatimin e masave, procesi i monitorimit do të realizohet në nivel objektivi. Verifikimi i të dhënave të raportuara realizohet pjesërisht online për të garantuar saktësinë e tyre. Përpunimi statistikor i të dhënave kryhet me anë të shifrimit të përgjigjeve sipas raporteve të marrë. Këto raporte janë kryesisht të karakterit narrativ, por edhe statistikor duke përdorur indikatorë të të performancës.

Në përputhje me procedurat që do të ndiqen për raportim & monitorimin në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)" për përgatitjen e raporteve të monitorimit do të ndiqen fazat e mëposhtme.

Faza 1.Marrja e të gjithë kontributeve nga institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standartet e sistemit (të rishikohet raporti);

Faza 2.Dërgimi i paketës së plotë për vlerësim në SASPAC në Kryeministri i në përputhje me standartet e sistemit. Paketa e plotë do të duhet të përfshijë materialet e mëposhtme:
2.1 Raport progresin e konsoliduar në përputhje me standartet e sistemit dhe metodologjinë e SASPAC;
2.2 Planin e zbatueshmërisë së masave për periudhën referuese në përputhje me standartet e sistemit dhe metodologjinë e SASPAC;
2.3 Pasaportën e Indikatorëve në përputhje me standartet e sistemit për periudhën referuese në përputhje me të gjithë indikatorët e pasaportës për reformën në administratën publike;
2.4 Bazën e të dhënave për vitin referues në zbatim të indikatorëve të pasaportës;

Faza 3: Konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga SASPAC në Kryeministri;

Faza 4: Organizimi i mbledhjes së KDS për konsultimin e paketës së konsoliduar dhe marrjen e komenteve nga aktorët;

Faza 5: Reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së Raportit të Monitorimit;

Faza 6: Publikimi i Raportit Vjetor

Faza 7: Dërgimi i procedurave (a.shenimet e takimit b.Konkluzionet operacionale) te mbledhjes së KDS-së dhe paketa finale/së bashku me linkun për njohje Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

• Metodologjia e vlerësimit të jashtëm dhe me pjesëmarrje

Procesi i vlerësimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë bazohet në një dokument me standardet e cilësisë për vlerësimin dhe monitorimin e politikave rinore[28] të përgatitur nga Forumi Rinor Evropian si edhe në një dokument të përgatitur nga SIGMA për vlerësimin e strategjisë së administratës publike[29] në Shqipëri. Ky dokumenti i fundit jep modelin se si duhen vlerësuar strategjitë ndërsektoriale duke u bazuar në strategjinë e Reformës së Administratës Publike.

1. Masa e pestë e politikës që ka të bëjë me zbatimin dhe administrimin e strategjisë parashikon zhvillimin e mekanizmit për monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë. Sipas këtij mekanizmi:

- ❖ Përmes një konference të përvitshme për rininë, mundësohet vlerësimi i SKR-së nga organizatat rinore dhe aktorë të tjerë në fushën e rinisë
- ❖ Realizohet vlerësim i jashtëm i përvitshëm për zbatimin e SKR-së
- ❖ Udhëzimet për buxhetimin gjinor dhe rinor, monitorimin, dhe vlerësimin zhvillohen për çdo nivel.

2. Dokumenti i përgatitur nga Forumi Rinor Evropian parashikon 8 standarde për vlerësimin e strategjive dhe secili standard ka treguesit e vet ku duhet bazuar vlerësimi.

- ❖ Standardi 1: Qasja e bazuar në të drejtat ndaj politikës rinore

Treguesit

1. Të drejtat e të rinjve si koncept njihen në dokumentet përkatëse të politikave
2. Politika rinore është qartazi e ankoruar në vlerat universale apo pluraliste, demokracisë dhe të drejtave të njeriut dhe u drejtohet pozitivisht dhe në mënyrë të barabartë të gjithë të rinjve, pavarësisht nga gjinia, raca, grupi etik etj.
3. Politika kombëtare për rininë miraton instrumentet ekzistuese ligjore për të drejtat e njeriut
4. Politika rinore i njeh të rinjtë jo si përfitues, por si bartës të të drejtave pjesëmarrëse. Kështu, ai vendos bartësit përkatës të detyrave si Shtetet Anëtare dhe aktorë të tjerë publikë, të cilët mund të mbahen përgjegjës për të drejtat e të rinjve.

- ❖ Standardi 2: Politika rinore e bazuar në dëshmi

Treguesit

1. Rregullisht kryhen kërkime mbi kushtet e jetesës, aspiratat dhe perceptimet e grupeve përfaqësuese të të rinjve.
2. Të dhënat e kërkimit janë të pavarura dhe nuk manipulohen në të gjitha pjesët e ciklit të politikave.
3. Burimet e duhura (financiare, njerëzore…) ndahen për kërkime në lidhje me të rinjtë.
4. Politika bazohet në informacione dhe kërkime të përditësuara.

---

[28] A Toolkit for Quality Standards on Youth Policy: https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47262391/Toolkit+on+Quality+Standards+for+Youth+Policy+-+European+Youth+Forum.pdf/c5d10d1b-c704-e45a-50f6-e0ace956ae42

[29] Dokument Koncepti mbi Sistemin e Monitorimit dhe të Vlerësimit për Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike të Shqipërisë, 2015: https://www.dap.gov.al/images/DokumentaStrategjik/Dokument_Koncepti_mbi_Sistemin_e_Monitorimit_dhe_te_Vleresimit.pdf

- Standardi 3: Politika rinore me pjesëmarrje

Treguesit

1. Të gjithë aktorët përkatës (organizatat e shoqërisë civile dhe sektorët e tjerë të shoqërisë) janë të përfshirë në të gjitha fazat e ciklit të politikave.
2. Organizatat rinore janë të përfshira në të gjitha fazat e ciklit të politikave.
3. Janë bërë përpjekje specifike nga autoritetet publike për të përfshirë të rinjtë e paorganizuar dhe të rinjtë me më pak mundësi gjatë gjithë ciklit të politikave.

- Standardi 4: Politika rinore me shumë nivele

Treguesit

1. Strategjia kombëtare për të rinjtë dhe politikat rinore pranojnë ekzistencën e kornizave të politikave në nivele të tjera.
2. Strategjia/objektivat e politikave për rininë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal janë të koordinuara dhe në këtë mënyrë plotësojnë dhe përforcohen reciprokisht
3. Masat e politikave rinore pasqyrojnë diversitetin gjeografik dhe socio-ekonomik brenda dhe ndërmjet njësive të ndryshme administrative (si bashkitë, rajonet, etj.).

- Standardi 5: Politika strategjike rinore

Treguesit

1. Ekziston një strategji gjithëpërfshirëse për të rinjtë.
2. Objektivat e strategjisë për të rinjtë janë të matshëm, me burime dhe të përcaktuara në kohë.

- Standardi 6: Disponueshmëria e burimeve për politikat rinore

Treguesit

1. Ka burime të mjaftueshme financiare të vëna në dispozicion nga qeveria për organizatat rinore, për të mbështetur zbatimin e politikave rinore.
2. Organizatat rinore dhe të rinjtë mbështeten me ngritjen e kapaciteteve nga autoritetet publike.
3. Ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore në dispozicion për autoritetet publike që punojnë në politikat rinore.

- Standardi 7: Angazhimi politik dhe llogaridhënia në politikën rinore.

Treguesit

1. Palët e ndryshme të interesit në procesin e krijimit të politikave marrin përgjegjësinë për veprimet e tyre dhe mund të mbahen përgjegjës për to.
2. Ka raportim publik nga politikëbërësit në të gjitha fazat e ciklit të politikave të politikës rinore në baza të rregullta.
3. Organizatat rinore po monitorojnë zbatimin e politikave rinore me qëllim që të sigurojnë plotësimin e nevojave dhe interesave të të rinjve.

- Standardi 8: Politika ndërsektoriale rinore

Treguesit

1. Ekziston një bashkëpunim efektiv dhe i koordinuar ndërmjet sektorëve, ministrive dhe subjekteve të tjera përkatëse.
2. Çështjet rinore përfshihen në fusha të ndryshme të politikave përkatëse, duke pranuar kështu që çështjet rinore janë horizontale.
3. Vlerësimi i politikës rinore përdoret si mekanizëm i të mësuarit nga kolegët për sektorë të ndryshëm të qeverisë.

3. Dokumenti i përgatitur nga SIGMA për vlerësimin e strategjive ndërsektoriale paraqet kornizën e vlerësimit dhe metodat se si duhet bërë ky proces duke i kushtuar rëndësi organizimit të brendshëm të punës brenda qeverisë dhe rregulloreve në bazë të të cilave bëhet monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë duke e venë theksin te:
   - Struktura e menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit institucional
   - Sistemi i monitorimit dhe raportimit për strategjinë
   - Vlerësimi i politikave për strategjinë
   - Procesin e monitorimit afat-mesëm të strategjisë
   - Udhëzimin për raportimet 3 mujore
   - Udhëzimin për raportimin vjetor
   - Modelin e raporteve dhe kalendarin e veprimtarive të monitorimit
4. Vlerësimi dhe monitorimi si proces bazohen edhe në elementet e përcaktuara nga OECD në lidhje me këtë gjë të cilat përfshijnë elementët e tabelës së mëposhtme:

	Ex-ante	I ndërmjetëm	Ex-post
RËNDËSIA	▪ A do ta zgjidhë problemin ndërhyrja e synuar? ▪ Cilave nevoja u përgjigjet ajo?	▪ A ka ndryshuar nevoja origjinale? ▪ A kërkon ndryshimi një rregullim korrespondues të ndërhyrjes?	▪ A ka arritur/prekur ndërhyrja grupin e synuar?
EFIKASITETI	▪ A ka të ngjarë që aktivitetet e parashikuara të çojnë në arritjen e objektivave? ▪ Cilat janë kostot? A ka ndonjë mënyrë për ta ofruar programin me kosto më efektive?	▪ A garantojnë rezultatet e arritura deri tani se objektivat do të arrihen? ▪ Cilët janë faktorët që ndikojnë në efektivitetin e pjesës x të ndërhyrjes?	▪ A janë zbatuar objektivat siç është planifikuar? ▪ Cilat ishin arsyet për suksesin e madh/mos-arritjen e objektivit x?

	Ex-ante	I ndërmjetëm	Ex-post
EFIÇENCA	▪ A është qasja e zgjedhur më efikase në kosto? ▪ A janë të justifikuara mirë mekanizmi i zbatimit - strukturat dhe proceset?	▪ Si mund të rritet efikasiteti i procesit? ▪ Çfarë procedurash institucionale duhet të thjeshtohen në mënyrë që zbatimi të bëhet më efikas?	▪ A është realizuar aktiviteti x duke përdorur qasjen me kosto më efikase? ▪ Sa e mirë ka qenë performanca e institucionit apo e procesit? ▪ Çfarë mësimesh mund të nxirren?
NDIKIMI	▪ Cili është ndikimi i pritshëm i ndërhyrjes? ▪ Cilat janë grupet e synuara të ndikimit?	▪ A sjell ndërhyrja gjatë zbatimit disa efekte të padëshiruara?	▪ Cili është ndikimi i aktivitetit kundrejt pritshmërive? ▪ Pse është ndikimi më i ulët /më i lartë se sa pritej?
QËNDRUESHMËRIA	▪ A ka të ngjarë që ndikimi të jetë afatgjatë? ▪ Cilat janë elementet që do ta garantojnë këtë?	▪ A ekzistojnë parakushtet për qëndrueshmërinë e objektivave? ▪ Çfarë mund të bëhet për të grasatuar që ato ekzistojnë? ▪ Cilët faktorë po ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e arritjeve?	▪ Cilat janë shanset që rezultatet do të zgjasin për një kohë të gjatë? ▪ Cilat janë kostot e ardhshme të parashikuara për programin? ▪ Cilat janë arsyet e qëndrueshmërisë së ulët të rezultateve?

- **Koordinimi i kuadrit strategjik**

1. **Struktura dhe nivelet**

Strategjia Kombëtare e Rinisë përcakton një organizim institucional të menaxhimit dhe të monitorimit me disa niveleve duke filluar nga niveli politik, duke vazhduar me nivel teknike ndër-sektorial dhe duke përfunduar me rolin e institucionit udhëheqës – Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MShRF).

Niveli i parë përbëhet nga institucioni kryesor - MShRF - që koordinon SKR-në në institucionet pjesëmarrëse me anë të Personave të Kontaktit (PK) të përcaktuar në çdo ministri dhe institucion varësie që lidhet për të koordinuar zbatimin e SKR-së me MShRF. Kabineti i MShRF-së dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) , si institucion në varësi të MShRF-së, kanë për detyrë koordinimin e PKR-së. Funksioni i nivelit të pare është menaxhimi operacional i SKR-së në baza ditore. Në bashkëpunim me personelin përgjegjës nëpër bashki AKR përgatit edhe raportet 2 mujore të monitorimit të aktiviteteve të strategjisë dhe i raporton ato pranë MShRF-së.

Niveli i dytë përbëhet nga Grupi Ndërqeveritar i Monitorimit të SKR-së. Ky grup është i nivelit të lartë i përbërë nga përfaqësuesit e emëruar zyrtarisht nga ministritë përkatëse. Ky grup kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë. Çdo gjashtë muaj pranë këtij grupi dorëzohet një raport monitorimi i përgatitur nga AKR. Raporti diskutohet dhe grupi merr masa për zbatimin e përgjithshëm të strategjisë duke pasur fokusin në ndikimin e reformave edhe në kuadër të SKZHI-së.

Niveli i tretë përbëhet nga Konferenca Vjetore e Rinisë e cila bën vlerësimin vjetor të SKR-së përmes angazhimit të shoqatave dhe organizatave rinore. Procesi i përzgjedhjes përcaktohet me udhëzime të MShRF-së dhe organizatat e përzgjedhura mund të bashkëpunojnë edhe organizata ndërkombëtare në fushën e rinisë dhe donatorë për të mbështetur realizimin e konferencës dhe procesin e vlerësimit vjetor të SKR-së.

Një përmbledhje e listës së treguesve/indikatorëve për Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 paraqitet në fund të këtij dokumenti.

PJESA V: Plani i Veprimit dhe Vlerësimet Financiare

Plani i detajuar i veprimit është bashkangjitur si aneks i këtij dokumenti strategjik dhe është hartuar në përputhje me metodologjinë e sistemit IPSIS. Plani i Veprimit është kostuar, dhe buxhetet e detajuar parashikohen në të njëjtën mënyrë në sistemin IPSIS, duke ofruar edhe ndarjen e duhur për programet buxhetore, edhe sipas institucioneve.

Ky kapitull i Strategjisë Ndërsektoriale të Rinisë përmban informacion në lidhje me financimin e këtij dokumenti duke e specifikuar sipas financimit që nevojitet për secilin nga qëllimet, në mënyrë që të realizohen secili prej tyre.
Më specifikisht, në këtë pjesë të strategjisë fillimisht jepet shpërndarja e burimeve sipas qëllimeve të politikës si dhe nevojat e paplotësuara me financim ose hendeku financiar për secilin nga qëllimet. Hendeku i financimit mund të mbulohet direkt nga buxheti i shtetit, donatorët nëpërmjet granteve apo edhe fonde të tjera të asistencës teknike.
Siç edhe është përmendur më lart, strategjia ka 3 qëllime politike dhe MSHRF do jetë institucioni përgjegjës për të koordinuar veprimet dhe për të bërë të mundur që masat e parashikuara në strategji të realizohen me sukses.

Përsa i përket hendekut të financimit, pjesa më e madhe e tij përbëhet nga shpenzimet për programe dhe baza të dhënash, ngritje kapacitetesh dhe studim i situatës për çështje të ndryshme.

Kosto totale e strategjisë për të tetë vitet është **7,717,439,273** lekë dhe hendeku financiar është 18.6%. Hendeku financiar në total është **--1,438,652,022** lekë. Në grafikun e mëposhtëm jepet hendeku financiar për secilin nga qëllimet e politikës.

Grafiku 1: Hendeku financiar për çdo qëllim politike



Siç shihet edhe në grafik 74% e hendekut përbëhet nga fondet që duhen për të realizuar qëllimin e parë, 15% e hendekut përbëhet nga fondet që duhen për të realizuar qëllimin e dytë dhe 11% janë fondet që duhen për të realizuar qëllimin e tretë të politikës

NEVOJAT PËR SHPENZIME KAPITALE DHE SHPENZIME KORENTE

Nevojat për shpenzimet korente dhe kapitale janë identifikuar pasi u përcaktuan qëllimet e politikës, objektivat specifikë dhe treguesti përkatës të performancës me pikësynimet dhe vlerat përkatëse të tyre për periudhën 2022 – 2029. Tre qëllimet e politikës për të cilat janë identifikuar edhe shpenzimet përkatëse janë:

1. Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore - Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar

2. Edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) dhe novacioni - Rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor, mbështetur nga shërbimet e këshillimit për punësim dhe orientimit në karrierë me prirje nga të rinjtë; rritja dhe përmirësimi i mundësive për të hyrë në tregun e punës në bazë të shanseve të drejta dhe të barabarta për të arritur potencialin e plotë rinor

3. Mirëqenia dhe Përfshirja - Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)

Grafiku 2: Përbërja e kostove sipas burimit të financimit



Siç vihet re, 79.6 % e kostove mbulohen nga buxheti i shtetit dhe lidhen me pagat dhe grantet që qeveria jep nëpërmjet AKR dhe institucioneve të tjera, 1.8% financohet nga donatorët dhe 18.6% janë kosto të pambuluara

Hendeku financiar përbëhet kryesisht nga shpenzimet për krijimin e portalit Të Rinjtë për Të Rinjtë, bazës së të dhënave për rininë, studimet e situatës aktuale dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve që merren dhe janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave rinore. Gjithashtu, në hendek përfshihen edhe nevojat për grantdhënie për organizatat rinore në mënyrë që ato të jenë sa më aktive dhe të kontribuojnë drejtpërdrejtë në informimin, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e të rejave dhe të rinjve.

Bazuar në klasifikimin ekonomik, 77% e kostos totale përbëhet nga shpenzimet korente dhe 23% përbëhet nga shpenzimet kapitale.

Grafiku 3: Përbërja e kostos totale bazuar tek klasifikimi ekonomik



Pjesa më e madhe e shpenzimeve korente përbëhet nga shpenzimet e tjera korente.

Duke pasur parasysh se në strategji janë paraqitur tre qëllime politikë, më poshtë jepet kostoja për secilin nga këto qëllime

Grafiku 4: Kosto sipas qëllimeve të politikës



Kostot e realizimit të qëllimit të parë janë 29.5% e kostove totale. Peshën më të madhe e zënë kostot për realizimin e qëllimit të dytë të politikës që zënë rreth 65.6% të kostove totale. Ndërkohë kostot e realizimit të qëllimit të tretë zënë 4.9% të kostove totale

Për të tre qëllimet e politikës janë identifikuar në total 9 objektiva specifikë. Grafiku i mëposhtëm jep peshën që zë çdo objektiv në koston totale të llogaritur për strategjinë

Grafiku 5: Pesha e objektivave specifikë



Siç shihet edhe nga grafiku, objektivi 2.1 dhe objektivi 2.2 kanë peshën më të madhe të shpenzimeve totale me përkatësisht 35.9% dhe 29.2%. Këta objektivë janë të lidhur drejtpërdrejtë me mbështetjen që jepet nga buxheti i shtetit për organizatat rinore dhe institucionet e tjera që merren me rininë. Ndërkohë Objektivi 1.1 zë 18.8% të shpenzimeve dhe lidhet me mbështetjen me grantdhënie për vënien në zbatim të politikave rinore.

Nëse analizohen fondet që duhen për të realizuar secilin qëllim të politikës, duke u bazuar tek pesha që kanë objektivat tek qëllimi, vihet re se për Qëllimin e parë, objektivi i tretë nuk ka financim nga donatorët. Ndërkohë, hendekun financiar më të lartë e ka objektivi 1.1.

Objektivi Specifik	Indicative Cost	Burimi i mbulimit deri ne 2022		Hendeku financiar 2022-2039 (në Lekë)
		Medium Term Budget Planning	External technical Assistance	
	Total Kosto	Total BSH	Total FH	
I. Specific Objective Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	**1,453,512,841**	777,523,904	11,290,000	**-664,698,937**
Specific Objective 2 Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	**665,086,102**	302,369,622	102,000,000	**-260,716,480**
Specific Objective 3 Studimet rinore zhvillohen dhe bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.	**160,960,198**	23,556,902	0	**-137,403,296**

Tek objektivi i parë përfshihet mbështetja që u jepet institucioneve dhe organizatave për tu bërë më aktive. Fokusi është tek krijimi dhe bërja plotësisht funksionale e KVR dhe KKR. Mbështetja e donatorëve është e ndjeshme dhe e dukshme tek objektivi i dytë që lidhet me koordinimin e politikës rinore. Të tre objektivat kanë hendek financiar që pritet të mbulohet kryesisht me mbështetjen e donatorëve dhe më pak me mbështetjen e buxhetit të shtetit. Gjithashtu, një pjesë e kostove lidhet me mirëfunksionimin e AKR

Ndërkohë nëse analizohet financimi i objektivave të qëllimit të dytë, mund të thuhet se objektivi i parë që lidhet me informimin dhe aftësimin e studentëve për të bërë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë aktive nuk ka financim të jashtëm. Këtu fokusi vihet tek aftësitë digjitale të të rinjve dhe rritja e mëtejshme e tyre.

Objektivi Specifik	Indicative Cost	Burimi i mbulimit deri ne 2022		Hendeku financiar 2022-2029 (në Lekë)
		Medium Term Budget Planning	External technical Assistance	
	Total Kosto	Total BSH	Total FH	
Objektivi Specifik 1 Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive	**2,766,870,421**	2,604,515,139	0	**-162,355,282**
2.2 Objektivi Specifik 2: Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuari cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.	**2,250,935,027**	2,216,489,027	14,000,000	**-20,446,000**
2.3 Objektivi Specifik 3: Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin	**46,539,280**	13,021,312	3,000,000	**-30,517,968**

Tek ky qëllim, tek dy objektivat e tjerë, financimi përbëhet nga buxheti i shtetit dhe nga donatorët. Përsa i përket hendekut financiar, objektivi i parë ka hendekun financiar më të madhe në vlerë dhe në përqindje ndaj totalit të kostos së qëllimit. Pra, vihet re se ka nevojë të madhe për të financuar politikat që i mirëinformojnë të rinjtë për mundësitë që kanë kur kalojnë në jetën aktive.. Gjithashtu, tek ky qëllim përfshihen edhe shpenzimet në lidhe me novacionin dhe digjitalizimin. Gjithashtu, masa shumë të rëndësishme që kanë nevojë për financim janë edhe masat që lidhen me lehtësitë që mund të krijohen për të rinjtë për të lëvizur

Tek qëllimi i tretë vetëm një nga tre objektivat ka financim nga donatorët në një vlerë relativisht të vogël. Ky qëllim përfshin masat që do ndërmerren për të përmirësuar Mirëqenien dhe Përfshirjen e të rinjve.

Objektivi Specifik	Kosto Totale	Burimi i mbulimit deri ne 2022		Hendeku financiar 2022-2029 (në Lekë)
		Buxheti i Shtetit	Financim i Huaj	
3.1 Objektivi Specifik 3.1 Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale	**165,967,773**	115,318,936	0	**-50,648,837**
3.2 Objektivi Specifik 2: Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	**161,297,116**	85,214,170	4,800,000	**-71,282,946**
3.3 Objektivi Specifik 3: Të rejat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimi në tyre në shoqëri dhe kanë mundësi rekreative dhe kulturore, duke përfshirë artet dhe sportet.	**46,270,515**	5,688,239	0	**-40,582,276**

Në këtë qëllim, përfshihen masat për të ndihmuar dhe nxitur të rinjtë që të kenë sjellje sa më të mira në shoqëri, larg ekstremizmit dhe dhunës, përfshihen masa për të rritur marrjen me sport e të rinjve dhe për të nxitur marrjen me sporte të ndryshme në të gjitha nivelet. Për këtë kërkohen financime për të krijuar hapësira miqësore me të rinjtë dhe për të krijuar sa më shumë terrene.

Aneks: Plani i Veprimit i kostuar

Policy Goal I	Policy Goal I: Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar								
Objektivi Specifik	**Institucionet përgjegjëse**		**Afati i zbatimit**		**Indicative Cost**	**Kosto të Mbuluara**		**Hendeku financiar 2022-2039 (në Lekë)**	**Financing Gap EUR (kursi kembimit: 1 EUR = 121 ALL)**
	Lead Institutions	**Participant Institutions**	**Start Date**	**End date**		**Medium Term Budget Planning**	**External technical Assistance**		
					Total Kosto	**Total BSH**	**Total FH**		
I. Specific Objective Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF, AKR	AKPA, Njësitë e Qeverisjes Vendore, KQZ, MAS	**2022**	**2029**	**1,453,512,841**	777,523,904	11,290,000	**-664,698,937**	**-5,493,380**
Specific Objective 2 Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	MSHRF, AKR	MFE, Ministritë e Linjës	**2022**	**2029**	**665,086,102**	302,369,622	102,000,000	**-260,716,480**	**-2,154,682**
Specific Objective 3 Studimet rinore zhvillohen dhe bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.	MSHRF, AKR	• MiSHMS, INSTAT	**2023**	**2029**	**160,960,198**	23,556,902	0	**-137,403,296**	**-1,135,564**
Kosto totale Qëllimi i Politikës I (objektiva specifike 1.1+1.2+1.3)					**2,279,559,141**	**1,103,450,428**	**113,290,000**	**-1,062,818,713**	**-8,783,626**

POLICY GOAL II: Rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor, mbështetur nga shërbimet e këshillimit për punësim dhe orientimit në karrierë me prirje nga të rinjtë; rritja dhe përmirësimi i mundësive për të hyrë në tregun e punës në bazë të shanseve të drejta dhe të barabarta për të arritur potencialin e plotë rinor

Objektivi Specifik	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Indicative Cost	Kosto të Mbuluara		Hendeku financiar 2022-2029 (në Lekë)	Financing Gap EUR (kursi kembimit: 1 EUR = 121 ALL)
	Lead Institutions	Participant Institutions	Start Date	End date		Medium Term Budget Planning	External technical Assistance		
					Total Kosto	Total BSH	Total FH		
Objektivi Specifik 1 Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive	MSHRF, MEF, AKPA, AKR	MAS, MiSHMS	**2022**	**2029**	**2,766,870,421**	2,604,515,139	0	**-162,355,282**	**-1,341,779**
2.2 Objektivi Specifik 2: Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuari cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.	MSHRF, MAS, AKR	MEF, AKPA, AKSHI, RASH, AKCESK	**2023**	**2029**	**2,250,935,027**	2,216,489,027	14,000,000	**-20,446,000**	**-168,975**
2.3 Objektivi Specifik 3: Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	MSHR, MEF, MAS	MiSHMS, AKR, AKPA, AKAPFK	**2023**	**2029**	**46,539,280**	13,021,312	3,000,000	**-30,517,968**	**-252,215**
Kosto totale Qëllimi i Politikës II (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3)			**2022**	**2029**	**5,064,344,728**	**4,834,025,478**	**17,000,000**	**-213,319,250**	**-1,762,969**

Policy Goal III: Qëllimi i politikës 3 – Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve/rejave në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)									
Objektivi Specifik	**Institutions**		**Implementation**		**Indicative Cost**	**Kosto të Mbuluara**		**Hendeku financiar 2022-2029 (në Lekë)**	**Financing Gap EUR (kursi kembimit: 1 EUR = 121 ALL)**
	Lead Institutions	**Participant Institutions**	**Start Date**	**End date**		**Medium Term Budget Planning**	**External technical Assistance**		
					Total Kosto	**Total BSH**	**Total FH**		
3.1 Objektivi Specifik 3.1 Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale	MSHRF, AKR, MAS, MD dhe MB	-AKSHI, AKCESK, AMA, Agjencia e Mbrojtjes së Të Drejtave të Fëmijëve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Bashkitë	**2022**	**2029**	**165,967,773**	115,318,936	0	**-50,648,837**	**-418,585**
3.2 Objektivi Specifik 2: Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHRF dhe MSHMS	AKR, ISHP	**2022**	**2029**	**161,297,116**	85,214,170	4,800,000	**-71,282,946**	**-589,115**
3.3 Objektivi Specifik 3: Të rejat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimi në tyre në shoqëri dhe kanë mundësi rekreative dhe kulturore, duke përfshirë artet dhe sportet.	MSHRF, MSHMS dhe MIE	AKR, AMMV, Bashkitë, MAS, MSHMS, MB, MD, ASCAP	**2022**	**2029**	**46,270,515**	5,688,239	0	**-40,582,276**	**-335,391**
Kosto totale Qëllimi i Politikës III (objektiva specifike 3.1+3.2+3.3)			**2022**	**2027**	**373,535,404**	**206,221,345**	**4,800,000**	**-162,514,059**	**-1,343,091**
Kosto Totale Strategjia Ndërsektoriale e Rinisë					**7,717,439,273**	**6,143,697,251**	**135,090,000**	**-1,438,652,022**	**-11,889,686**

Treguesit e Monitorimit të dokumentit të Strategjisë

Treguesit e Monitorimit të SKR do të bazohen në përdorimin e një numri treguesish kryesorë të performancës në lidhje me qëllimet e politikës dhe objektivat specifikë të planit të veprimit, siç pasqyrohen në këtë të fundit. Progresi i zbatimit të SKR do të monitorohet dhe vlerësohet duke matur periodikisht treguesit, të cilët janë vendosur në përputhje me qëllimet dhe objektivat e politikës përkatëse. Më poshtë tabela e Treguesëve Kryesorë të Performancës sipas tre qëllimeve të politikës të SKR.

Tabela 21: Treguesit e Monitorimit të SKR 2022-29

Nr.	Treguesit	Vlera Bazë	Vlera e synuar 2029	Burimi i verifikimit
Qëllimi i Politikës 1: Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar				
1.	Indeksi botëror i zhvillimit të rinisë	2020 0.764/1	0.8/1	Raporti Vjetor i Commonwealth "Raporti Vjetor i Zhvillimit të Rinisë"
2.	% e të rinjve që raportojnë se ndihen të përfaqësuar në politikat rinore të zbatuara në nivel qëndror/vendor	2020 20%	80%	Raport specifik i studimit "Përfaqësimi i të rinjve në politikat rinore në nivel qëndror dhe vendor" Sondazhi i MSHFR
3.	% e buxhetit të shtetit dedikuar për programet mbi rininë	2021 0.05%	2.4%	Raportet e MFE/ MSHRF
OS1.1a	% e bashkive ku janë ngritur Qëndrat Rinore Multifunksionale	2022 16%	100%	Raportet e AKR
1.1b	Numri i Këshillave Vendore të ngritur dhe funksionale (në nivel bashkie)	2022 21 Bashki	100%	Raportet e AKR

1.1.c	Ligji "Për Rininë" i rishikuar dhe miratuar	2021 Ligji jo i rishikuar	Ligji i rishikuar dhe miratuar	Raportet e MSHRF
1.1 d	Ligji "Për Vullnetarizmin" i rishikuar dhe miratuar	2021 Ligji jo i rishikuar	Ligji i rishikuar dhe miratuar	Raportet e AKPA, MFE, MSHRF
1.2 a	Numri/përqindja i/e bashkive që kanë ngritur kënde digjitale të informimit rinor (info-points)	2022 2 bashki/ 3.27%	100%	Raportet e AKR
1.2 b	Platforma rinore "Të rinjtë për të rinjtë" e ngritur, funksionale dhe e përditësuar	2021 Platforma jo e ngritur	Platforma e ngritur, funksionale dhe e rishikuar	Raportet e AKR
1.3 a	Politikat zhvillimore rinore të hartuara bazuar në analizë	2021 -	8	Të dhënat e MSHRF, AKR
Qëllimi i politikës 2: Mbështetet dhe n-xitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.				
2.1.a	Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës sipas gjinisë	2021 52.5% e të rinjve nga të cilët 58.6% meshkuj dhe 46.3 % femra	60% e të rinjve	Të dhënat e INSTAT
2.2.a	Numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi/mobiliteti arsimore	2021 4347 të rinj	Trend Rritës	Të dhënat e MAS, AKKSHI, AKPA
2.3.a	Shkalla e papunësisë së të rinjve (%) të ndarë sipas gjinisë	2021 20.9% e të rinjve nga të cilët 20.5% meshkuj dhe 21.4 5 femra	18.3% e të rinjve	Të dhënat e INSTAT
2.3.b	% e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit	2021 45%	Trend Rritës	Të dhënat e AKPA

2.3.c	% e të rinjve që kanë filluar biznesin me mbështetjen financiare të shtetit.	2019 26%	5% mbi vitin paraardhës	Raportet e studimeve të kryera nga MSHRF, MFE organizata
Qëllimi i politikave 3: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)				
3	Indeksi i Progresit të të Rinjve	2020 68.49/100	55/100	Raport vjetor i European Youth Forum (Forumi Evropian i të Rinjve)
3.2.a	% e të rinjve që raportojnë se praktikojnë stile jetese të shëndetshme	2021 -	5% rritje mbi vitin paraardhës	Sondazhi i kyer nga MSHRF
3.2.b	% e qendrave shëndetësore të pajisura me mjedise miqësore për rininë	2021 -	5% rritje mbi vitin paraardhës	Të dhënat e MSHMS
3.2.c	% e nëpunësve publikë të trajnuar mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë	2021 -	5% rritje mbi vitin paraardhës	Të dhënat e MSHMS; ASPA